


PTK: NGA AGIMI DERI NË MUZG





PTK: NGA AGIMI DERI NË MUZG



2015

Financuar nga:
Ky publikim është pjesë e angazhimit në mes të
Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) dhe
Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!



Deklaratë mohimi:
Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk
përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve.

Përpiluar nga:
Lorik Bajrami

Hulumtues:
Qëndrim Bunjaku, Bardha Nikoliqi dhe Arton Demhasaj

Dizajni dhe Faqosja:
Faton Selani

Originali është shkruar në shqip

Publikuar nga:
Organizata për Demokraci,
Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!
Rruga: 2 Korriku; Nr.4/4; Prishtina, Kosova
Tel / +381 (0)38 2248 506




E drejta autoriale © 2015 nga Organizata Çohu! Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

AKRONIMET:

AAK	→	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	→	Aleanca për Kosovën e Re
ARKEP	→	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
ART	→	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikimeve
BiD	→	Bordi i Drejtorëve
EULEX	→	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit
GJNA	→	Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit
QeK	→	Qeveria e Kosovës
IPKO	→	Grupi Telekom Slovenije
KQZ	→	Komisioni Qendror Zgjedhor
KQPPT	→	Komisioni Qeveritar për Privatizim e Postës dhe Telekomit
LDK	→	Lidhja Demokratike e Kosovës
LNP	→	Ligji për Ndërmarrjet Publike
MVNO	→	Operator Mobil Virtual
NPQ	→	Ndërmarrjet Publike Qendrore
NSh	→	Ndërmarrjet Shoqërore
NJPMNP	→	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
OTT	→	Over the Top Services
PDK	→	Partia Demokratike e Kosovës
PTK	→	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
SRSG	→	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UNMIK	→	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZAP	→	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

TABELA E PË



ERMBAJTJES

**6. EFEKTET
NEGATIVE TË
PEZULLIMIT TË
INVESTIMEVE
NË PTK**

29

**7. NDIKIMI
INDUSTRIAL
NË TREGUN E
TELEFONISË:
KONTRATA ME
Z-MOBILE**

35

**8. DY TENTIMET
E DËSHTUARA PËR
TA PRIVATIZUAR
PTK-NË**

8.1 Tentimi
i parë për ta
privatizuar PTK-në:
Tenderi që ekspozoi
konfliktin e
interesit

8.2 Tentimi i dytë
për ta privatizuar
PTK-në

39

**9. ZHVILLIMET E
FUNDIT NË PTK**

45

10. PËRFUNDIM

47

11. REKOMANDIME

48

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës

2008

Pas deklarimit të pavarësisë, më 2008, dhe bazuar në nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Qeveria e Kosovës bëhet hisedari i ri me 100% të aksioneve në Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës.

2005

Më 2005, AKM-ja mori vendim që ta transformojë PTK-në në një shoqëri aksionare, e quajtur Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Sh.A.

2005

Rregullorja e UN-MIK-ut 2005/18 i ka dhënë të drejtën Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), për t'i transformuar ndërmarrjet publike në korporata.



2012

Që nga gushti i vitit 2012, Posta e Kosovës Sh.A. funksionon si njësi e veçantë e biznesit.



Për shkak të dështimit të privatizimit të PTK-së, Qeveria e Kosovës, vazhdon t'i posedojë 100% të aksioneve në PTK.

1999

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), u themelua më 1959.



PTK KA 2 NJËSI BIZNESI:

Këto njësi përfshijnë: Telefoninë mobile dhe fikse; Internet; Televizion si dhe shërbime të menaxhuara të teknologjisë informative për konsumatorë biznesi.

• Vala – Operatori Mobil

• Telekom i Kosovës



2011

Bazuar në Strategjinë e Privatizimit të PTK-së, në fund të vitit 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, mori vendim për ta ndarë Postën e Kosovës nga PTK-ja.



2010



Më 2010, Qeveria e Kosovës mori një vendim që t'i ndal investimet në PTK, për shkak të procesit të privatizimit, vendim ky i cili ka ndikuar shumë në rënien e vlerës së përgjithshme të kompanisë.

2013

Vala - Operatori Mobil i PTK-së, është gjeneruesi më i madh i të hyrave të kompanisë, me rreth 88% në vitin 2013.


2014



Në fund të vitit 2014, PTK-ja lëshoi në përdorim ofrimin e shërbimeve brez-gjëra, e njohur si teknologjia 3G, përderisa në fund të muajit prill 2015, lëshoi në përdorim edhe teknologjinë 4G.

2010-2013

Përgjatë viteve 2010-2013, kishte dy tentime të dështuara për t'i privatizuar 75% të aksioneve të PTK-së.



Sot, PTK mban vetëm 53.40% të tregut të përdoruesve të telefonisë mobile dhe deri 58.62% të të hyrave nga tregu i telefonisë mobile. Rivali kryesor i PTK-së, operatori IPKO, mbanë deri 36.20% të tregut të përdoruesve të telefonisë mobile dhe deri 34.84% të të hyrave nga tregu i telefonisë mobile. Dy operatorët mobil virtual (Z-Mobile dhe D3), mbajnë deri në 10.40% të tregut të përdoruesve të telefonisë mobile dhe deri në 6.50% të të hyrave nga ky treg.

METODOLOGJIA

Ky raport hulumtues është përpiluar duke u bazuar në burime primare dhe sekondare, por ngërthen në vete edhe analizë cilësore dhe sasiore të të dhënave. Për sa i përket burimeve primare, ligjet dhe dokumentet bazë që rregullojnë fushën e telekomunikacionit, me theks të veçantë ato që prekin PTK-në, janë marrë për bazë. Për më shumë, ekipi hulumtues ka shfrytëzuar arkivin e gjerë të organizatës të intervistave të realizuara me hisedarë të ndryshëm të sektorit të telekomunikacionit, por është mbështetur edhe në ato të realizuara për nevoja specifike të këtij hulumtimi.

Për sa i përket burimeve sekondare, ky raport hulumtues mbështetet në një volum të madh të të dhënave të raporteve të institucioneve relevante, mediave dhe organizatave të ndryshme dhe pikënisje ka vitin 2007.

Raporti hulumtues merr në konsideratë zhvillimet kryesore në sektorin e telekomunikacionit që nga koha e hyrjes në treg të operatorit të dytë të telefonisë mobile, IPKO, më 2008. Fokus primar i tij është të vlerësojë se deri në çfarë mase ndërhyrjet politike përfshirë ndikimet e ardhura nga industria e telekomunikacionit kanë kontribuar, krahas zhvillimeve tjera, në rënien e vazhdueshme të vlerës së PTK-së.

Duke qenë se të hyrat kryesore PTK-ja i gjeneron nga operatori i telefonisë mobile 'Vala', ky hulumtim do të fokusohet dhe analizojë kryesisht trendët dhe rrethanat që kanë çuar në rënien e të hyrave dhe të vlerës së këtij operatori. Sidoqoftë, në kuadër të hulumtimit janë përfshirë edhe aspekte të telefonisë fikse, por përmenden edhe disa sfida për sa i përket rritjes së penetrimit të internetit nga ana e PTK-së.

Në përgjithësi, hulumtimi është i ndarë në shtatë pjesë përbërëse. Pjesa e parë analizon tregun si dhe financat e kompanive të telefonisë mobile me fokus të posaçëm ato të PTK-së. Të dhënat në këtë drejtim kanë pikë referimi vitin 2007, duke qenë se informacioni bazë rreth tregut si dhe të hyrave në fushën e telekomunikacionit është i qasshëm vetëm nga ky vit. Kjo pjesë përmban edhe një hulumtim dhe analizë më të thellë të zhvillimeve kryesore të cilat kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në sektorin e telekomunikacionit në përgjithësi dhe në funksionimin e PTK-së, në veçanti. Pjesa e dytë dhe e tretë thekson ndërhyrjet politike dhe pasojat e gjeneruara nga punësimet partiake, mungesën e funksionimit të mekanizmit të llogaridhënies

si pasojë e politizimit të strukturave udhëheqëse të PTK-së. Pjesa e katërt flet për pasojat dërmuese që kanë afektuar PTK-në, si pasojë e pezullimit të investimeve kapitale për më shumë se tri vite. Pjesa e pestë merr në shqyrtim kontratën e PTK-së me 'Z-Mobile' dhe pasojat që i ka sjellë ajo. Pjesa e gjashtë ndalet në dy tentimet e dështuara të privatizimit të PTK-së, nismë që pati filluar në vitin 2009 dhe përfundoi në fund të vitit 2013. Qëllimi në këtë drejtim është që të ofrohet një analizë përshkruese përkitazi me vendimet dhe rrethanat që çuan në dështimin e privatizimit të PTK-së dhe pasojat që i ka sjellë ky proces për ndërmarrjen. Pjesa e fundit e raportit jep një përshkrim të shkurtër nga Plani i Biznesit i PTK-së, për vitet 2015-2019, me fokus të veçantë thekson rrugën që ndërmarrja duhet ndjekur për ta ndaluar trendin tashmë linear të rënies, por vë në pah edhe disa konfrontime të fundit në mes qeverisë dhe strukturave drejtuese të PTK-së.

1. HYRJE

Ky raport hulumtues ofron një ekzaminim të detajuar mbi zhvillimet dhe shkaqet kryesore që çuan në rënie të vazhdueshme dhe siç duket të pandalshme të vlerës së kompanisë publike më fitimprurëse në vend, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës - PTK. Në fakt, objektivi kryesor i këtij hulumtimi është të vlerësojë se deri në çfarë mase ndikimi politik dhe ai industrial, keqpërdorimi dhe keq-menaxhimi bashkërisht kanë ndikuar në tkurrjen e të hyrave por edhe të vlerës së përgjithshme të kompanisë. Raporti hulumtues në thelb përbën një analizë gjithëpërfshirëse i cili sjell në vëmendje vendimet kryesore të cilat kanë afektuar performancën e PTK-së, përfshirë integritetin dhe rentabilitetin e saj.

Hulumtimi mëton të vlerësojë aftësinë e PTK-së, por edhe të hisedarëve që kanë marrë vendime në emër të ndërmarrjes, që të përballojnë konkurrencën në tregun e telefonisë mobile që nga viti 2008, kur kompania e dytë e telefonisë mobile, IPKO, filloi operimin.

Që nga koha e hyrjes në treg e operatorit të dytë të telefonisë mobile, PTK-ja ka shënuar rënie konstante në të hyrat e saj, përfshirë edhe rënie drastike të vlerës së përgjithshme të ndërmarrjes. PTK-ja është ndërmarrje e cila fokusin kryesor e ka në ofrimin e shërbimeve të telefonisë së zërit prej nga ka gjeneruar profitin më të madh. Në këtë kuadër, ndryshimet në fushën e telekomunikacionit si teknologjia brez-gjerë e cila ka mundësuar përdorimin e aplikacioneve pa pagesë për nevoja dhe shërbime të ndryshme, ka kontribuar në rënien e të hyrave të PTK-së. Sidoqoftë dhe ashtu siç do të dokumentohet në këtë raport hulumtues, ndikim domethënës në këtë drejtim kanë pasur edhe vendimet e shumta të marra nga hisedari kryesor (qeveria), si dhe ndërhyrjet e drejtpërdrejta të partive politike, të cilat kanë ndikuar negativisht në funksionimin e ndërmarrjes.


Ndikim të theksuar në aspektin e qëndrueshmërisë së kompanisë ka luajtur edhe influenca industriale që ka ardhur kryesisht si rezultat i qeverisjes së dobët të tregut të telekomunikacionit nga organet vendim-marrëse, ato mbikëqyrëse si dhe ato rregullative. Korrupsioni, mungesa e profesionalizmit si dhe mos respekti për praktikën e mira të qeverisjes korporative të OECD-së, ishin vetëm disa nga rezultatet e përfshirjes së interesave private të akterëve politik dhe industrial në sektorin e telekomunikacionit.

PTK-ja është goditur shumë nga vendimi i qeverisë për ndaljen e investimeve në disa nga projektet më kapitale për këtë kompani, vendim ky i cili erdhi si rezultat i fillimit të procesit shumë të gjatë, të mundimshëm dhe në fund të dështuar të privatizimit. Që nga viti 2010, kur edhe është marrë ky vendim, investimet kapitale në PTK kanë qenë pothuajse zero, deri sa ato rinisën në fund të vitit 2014.

Po ashtu, punësimi pa asnjë kriter dhe jashtë çdo planifikimi strategjik në PTK i qindra individëve, është njëri nga shembujt më të spikatur të përdorimit të PTK-së, për qëllime partiake/elektorale dhe dëmtimit shumë të madh që i është bërë kompanisë. Në këtë kuadër, edhe marrja nga ana e qeverisë pa asnjë kontroll dhe studim paraprak e 465 milionë eurove në formë dividende nga buxheti i PTK-së, me të vetmin qëllim mbushjen e boshllëqeve në buxhet, ka kontribuar në shterjen e financave të kompanisë, ka penguar zhvillimin e saj, si dhe i ka pamundësuar PTK-së, përballimin e konkurrencës shumë të ashpër.

Të gjeturat e hulumtimit konfirmojnë se qeveria, organet mbikëqyrëse (NJPMNP), dhe rregullative (ARKEP), por edhe strukturat drejtuese të PTK-së (BD-ve dhe menaxhmenti), kanë dështuar të ofrojnë nivel të domosdoshëm të transparencës në shumë prej projekteve dhe vendimeve që kanë afektuar kompaninë.

FIG. 01 DIVIDENTA QË PTK-JA KA NDARË PËR
BUXHETIN E SHTETIT (2007-2014)



Burimi: Raportet vjetore financiare të PTK-së.

2. ANALIZA E KONTEKSTIT: TREGU DHE FINANCAT

Tashmë është vetëm pjesë e historisë koha kur kosovarët mburrëshin me kompaninë publike më fitimprurëse në vend, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës - PTK. Dikur, PTK-ja ka simbolizuar progresin që vendi kishte arritur përballë sfidave të vazhdueshme të konsolidimit të shtetësisë së tij. Krahësuar me të gjitha kompanitë publike në vend, PTK ka gjeneruar profitin më të lartë financiar, kryesisht për shkak të natyrës fitimprurëse të industrisë së telekomunikacionit. Që nga viti 2007 dhe deri më sot, PTK-ja i ka ndarë buxhetit të shtetit 465 milionë euro dividendë.¹

Përderisa kompania ishte në gjendje të mirë financiare dhe përballonte ofrimin e shumave të mëdha të parave për buxhetin e shtetit, kontrolli i saj si nga mekanizmat mbikëqyrës institucional por edhe nga publiku ka qenë i mangët. Kjo kryesisht për shkak se deri më 2007 PTK-ja kishte monopol të plotë në fushën e telefonisë mobile dhe asaj fikse, dhe në këtë aspekt, mungesa e konkurrencës pati krijuar një komoditet të paqëndrueshëm për kompaninë.

PTK-ja, ashtu sikur edhe institucionet e tjera publike, është ballafaquar me ndërhyrje të vrazhdë dhe të gjithëmbarshme politike si në çështjet e menaxhimit strategjik ashtu edhe në ato ditore. Kjo kompani është sfiduar për më shumë se 3 vite nga mungesa e tërësishme e investimeve kapitale, gjë që i ka pamundësuar përballimin e konkurrencës, ka kaluar nëpër dy faza shumë të rënda dhe në fund të dështuara të transformimit të pronës (privatizimit) si pasojë e mos planifikimit dhe menaxhimit të duhur të të gjithë procesit. Në disa raste PTK-ja është ndikuar drejtpërdrejt nga interesat e biznesit privat të sektorit të telekomunikacionit duke e dëmtuar atë në favor të sektorit privat. Rasti më i spikatur në këtë drejtim është nënshkrimi i kontratës në mes PTK-së dhe 'Dardafone.net LLC', rreth ofrimit të shërbimeve virtuale të telefonisë mobile. Kontrata parashihte një ndarje jo të favorshme të të hyrave për PTK-në, vetëm 27%, duke

përfshirë këtu thirrjet që bëhen në kuadër të operatorit virtual, edhe përkundër faktit që 'Dardafone.net LLC', do të operonte bazuar në infrastrukturën dhe frekuencat GSM të ndërmarrjes publike. Kjo kontratë është vlerësuar se ka dëmtuar ndërmarrjen publike duke mos arritur objektivat bazike atë të rritjes së numrit të konsumatorëve dhe të ndalimit të rënies së të hyrave të përgjithshme të PTK-së.

Si rrjedhojë e mënyrës se si është trajtuar në përgjithësi PTK-ja nga qeveria qendrore, kjo kompani sot gjendet në një situatë shumë të rëndë si në aspektin e funksionimit të qëndrueshëm të saj ashtu edhe në atë financiar. Bazuar në të dhënat e ofruara nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP, vërehet qartazi një rënie e vazhdueshme dhe lineare e numrit të përdoruesve të telefonisë mobile, por edhe përqindjes së të hyrave të gjeneruara nga njësia e biznesit më fitimprurëse e PTK-së, telefonia mobile.

Në fund të vitit 2007 PTK-ja mbante rreth 89.10% të tregut të përdoruesve (konsumatorëve) të telefonisë mobile, përderisa operatori i dytë, IPKO, që në fund të këtij viti kishte filluar operimin, zotëronte vetëm 10.90% të këtij tregu. Të dhënat e tre mujorit të fundit për vitin 2014 nga ARKEP-i tregojnë se situata ka ndryshuar thellësisht ku tashmë PTK-ja mbanë vetëm 53.40% të tregut të përdoruesve të telefonisë mobile kurse IPKO, ka arritur të kap 36.20% të tij. Operatori mobil virtual, 'Z-mobile', i cili shfrytëzon infrastrukturën dhe frekuencat GSM të PTK-së, ka arritur të sigurojë 10.40% të tregut të përdoruesve të telefonisë mobile.

Për sa i përket përqindjes së të hyrave, situata është e krahasueshme me trendin në rënie të përdoruesve të telefonisë mobile të elaboruar më lart. Deri sa më 2007, PTK-ja zotëronte deri në 97.69% të tregut për sa i përket të hyrave nga telefonia mobile, diçka normale në kushte të monopolit të plotë të tregut që e zotëronte ajo, PTK-ja sot mbanë vetëm 58.62% të këtij tregu. Dy rivalët kryesorë të PTK-së kanë shënuar rritje konstante dhe sipas të dhënave të fundit, IPKO sot posedon 34.84% të të hyrave nga tregu i telefonisë mobile, ndërsa Z-Mobile, zotëron 6.35% të të hyrave nga ky treg. Kjo rënie lineare e përdoruesve dhe e të hyrave të PTK-së ka ndodhur edhe përkundër faktit që ndërmarrja në vitin 2014, sipas vlerësimeve të raportit të fundit të ARKEP,

1. Shuma e përgjithshme e dividendës që i është ndarë buxhetit të Kosovës është kalkuluar nga raportet vjetore financiare të PTK-së, të cilat mbulojnë periudhën e viteve 2007-2013. Për më shumë detaje shih raportet: <http://www.ptkonline.com/ptk/raport/>
Për më shumë, në shumën totale të dividendës është përfshirë edhe vendimi i fundit i Qeverisë së Kosovës (QeK), i cili ka obliguar PTK-në të ndajë 10 milionë euro për vitin 2014, si dhe 5 milionë të tjera që PTK i ka ndarë në fund të vitit 2014. Shih vendimin e QeK: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi-et_e_Mbledhjes_se_196-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2014\(1\).pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi-et_e_Mbledhjes_se_196-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2014(1).pdf)

FIG. 02 NDARJA E TREGUT TË TELEFONISË MOBILE (NË %) SIPAS PËRDORUESVE NË TREMUJORËT E FUNDIT (T4 2007- T4 2014)





FIG. 03 NDARJA E TREGUT E TELEFONISË MOBILE (NË %) SIPAS TË HYRAVE NË TREMUJORËT E FUNDIT (T4 2007 - T3 2014)



ka ofruar shërbime komunikimeve elektronike të cilësisë së lartë për përdoruesit fundor.²

Përderisa PTK-ja, kishte monopol të plotë në treg deri më 2007, të hyrat e saj shënonin ngritje të vazhdueshme përfshirë këtu edhe profitin operativ i cili kishte arritur deri në 148%.³ Më 2008, të hyrat e PTK-së u tkurrën për 21 milionë euro, apo për 11.49%. Kjo rënie e të hyrave për vetëm një vit ka qenë pothuajse e pashmangshme marrë parasysh që ky ishte viti i parë i operimit të operatorit të dytë të telefonisë mobile, IPKO. Por, kjo rënie, vije në shprehje edhe për shkak se ARKEP-i, me rastin e hyrjes së IPKO-së në treg, pati marrë një vendim⁴ rreth çmimeve preferenciale të tarifave të thirrjeve ku favorizonte operatorin e ri mobil. Vendimi i ARKEP-it parashihte çmime shumë më të lira të thirrjeve nga operatori i ri 'IPKO' tek 'Vala', duke i krijuar kështu kushte shumë të favorshme për operim dhe nxënie të tregut operatorit të ri. Ky vendim, i cili ishte pjesë e politikave qeverisëse për liberalizim të tregut të telefonisë mobile ku PTK-ja, mbante monopol të plotë, ndikoi në ulje drastike të çmimit në tarifat e thirrjeve të telefonisë mobile por edhe në modernizim të shërbimeve të telefonisë mobile në përgjithësi.

Sidoqoftë, që nga viti 2007, kur të hyrat e përgjithshme të PTK-së arritën kulmin, me rreth 183 milionë euro, të ardhurat bruto të kompanisë kanë shënuar rënie të vazhdueshme dhe në vitin 2014, ndërmarrja ka arritur të gjenerojë 99.5 milionë euro.

Kjo rënie e të hyrave dhe përdoruesve të telefonisë mobile bashkë me atë të telefonisë fikse në PTK, është pjesërisht pasojë e zhvillimit dhe avancimit domethënës të teknologjisë dhe rritjes së përdorimit të pajisjeve dhe telefonave të mençur. Më konkretisht, kjo rënie vije në shprehje për shkak të përdorimit të aplikacioneve të ofruara nga ofruesit e përmbajtjes 'content' dhe aplikacioneve, nga përdoruesit e telefonisë mobile të ashtuquajtur; '*Over the Top Services (OTT)*', të cilat mundësojnë përdorimin e aplikacioneve të bazuara në platformën e internetit për qëllime të komunikimit.

2 Raporti Vjetor i ARKEP për Kualitetin e Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike (periudha Janar - Dhjetor 2014); mars, 2015. <http://www.arkep-rks.org/repository/docs/Raporti%20Vjetor%20i%20ARKEP%20per%20QoS.pdf>

3 Instituti Riinvest; "Dilema dhe ngecje në rrugën e shpejtë - Privatizimi i ndërmarrjeve publike në Kosovë"; Tetor 2008; faqe29.

4 Më 2007, ARKEP mori vendim të ofroj tarifa preferenciale përkitazi me çmimet e terminimit të thirrjeve në mes dy operatorëve mobil (IPKO dhe PTK), duke e justifikuar këtë vendim si të nevojshëm në mënyrë që mbështes zhvillimin dhe liberalizimin e sektorit të telefonisë mobile. Shih vendimin e ARKEP: <http://www.arkep-rks.org/repository/docs/vendim-ipko-ptk.pdf>

Trendi i rënies së të hyrave nga telefonja mobile, por edhe nga ajo fikse të PTK-së, siç shihet në tabelën 1, sipas shënimeve zyrtare nga DG Connect, regjistrohet edhe në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian (BE), por edhe vendeve të rajonit. Normat (%) e rënies në vendet e BE-së shkojnë deri në - 7.2% për shërbimet e telefonisë fikse dhe - 2.7% në shërbimet e telefonisë mobile, ndërsa për vendet rajonale kjo normë është edhe më e lartë. Tabela në vijim paraqet të hyrat nga shërbimet e komunikimeve elektronike në shtetet e BE-së të publikuara në raportin e fundit të Komisionit Evropian '*Digital Agenda Scoreboard 2013*'.⁵ Ky trend i rënies së të hyrave nga telefonja mobile vërehet edhe tek operatorët tjerë vendor të telefonisë mobile dhe është i krahasueshëm me tendencat në rënie të PTK-së.

Në figurat e mëposhtme janë dhënë të hyrat e përgjithshme të sektorit të telekomit nga viti 2007–2014, ku edhe siç mund të vërehet të hyrat totale të këtij sektori në Evropë janë zvogëluar nga 13% në terma nominale që nga viti 2008

Të dhënat e fundit nga plani i biznesit të PTK-së tregojnë se baza e përdoruesve të internetit fiks është rritur për 1% nga TM1 2014, në krahasim me TM4 2013, përderisa baza e këtyre përdoruesve në TM2 2014, për dallim me TM1 2014, është rritur për 7%. Në anën tjetër, rritja e përdoruesve në internet mobil 3G, në TM1 2014, në dallim me TM4 2013, është 41%, përderisa rritja vazhdon edhe në TM2 në krahasim me TM1 2014 për 18%.⁶


Ky trend në rritje i bazës së përdoruesve të internetit dëshmon, ashtu sikurse po tregojnë edhe trendët global, se PTK-ja e ka të pashmangshme transformimin strukturor të saj, e që nënkupton kalimin nga një kompani e fokusuar ekskluzivisht në ofrimin e shërbimeve të telefonisë së zërit në ndërmarrje që ofron shërbime të shkëmbimit të të dhënave me shpejtësi super të shpejtë.

5 European Commission; "Digital Agenda Scoreboard 2013"; June 2013. <https://ec.europa.eu/digital-agenda/sites/digital-agenda/files/DAE%20SCOREBOARD%202013%20-%20SWD%202013%202017%20FINAL.pdf>

6 Plani i biznesit i PTK-së, (2015-2019). http://mzhe.rks-gov.net/npmnp/repository/docs/Plani_i_Biznesit_2015__PTK_sha.pdf

FIG. 04 KRAHASIMI I TË DHËNAVE NGA PASQYRAT FINANCIARE TË PTK-SË (2007-2014)

- Të hyrat
- Fitimi neto për vitin
- Fitimi i mbartur
- Devidendë
- Komisionet (Pagesat) për Monaco Telecom



Burimi: Raportet vjetore financiare të PTK-së (2007-2014)

TABELA 1 INDIKATORËT KRYESOR TË TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE 2011-2014

Nr.	Përshkrimi	2014	2013	2012	2011	Ndryshimi krahasuar me vitin 2013 (%)	Ndryshimi krahasuar me vitin 2012 (%)	Ndryshimi krahasuar me vitin 2011 (%)
1	Numri i linjave të telefonisë fikse në fund të viteve	315,145	315,952	315,952	315,952	▲ 5.53	▲ 5.53	▲ 5.53
1.1.	<i>Numri i përdoruesve të telefonisë fikse</i>	64,297	78,639	81,603	86,014	▼ -22.3	▼ -26.21	▼ -33.77
1.2	<i>Penetrimi i telefonisë fikse (%)</i>	3.54%	4.33%	4.69%	4.96%	▼ -22.31	▼ -32.48	▼ -40.11
2	Numri i përdoruesve të telefonisë mobile në fund të viteve	1,731,291	1,643,429	1,663,844	1,478,944	▲ 5.07	▲ 3.89	▲ 14.57
2.1	<i>Penetrimi i telefonisë mobile (%)</i>	95.36%	90.52%	95.63%	85.30%	▲ 5.07	▼ -0.28	▲ 10.54
3	Numri i përdoruesve të internetit në fund të viteve	190,802	166,400	151,694	143,243	▲ 12.78	▲ 20.49	▲ 24.92
3.1	<i>Penetrimi i shërbimeve të internet-it (%)</i>	10.97%	9.18%	8.70%	7.92%	▲ 16.31	▲ 20.69	▲ 24.92
4	Të hyrat (€)	182,106,730	206,919,730	226,477,813	239,518,037	▼ -13.62	▼ -24.36	▼ -31.52
4.1	<i>Telefonia fikse</i>	16,283,180	15,777,288	17,377,000	20,039,454	▲ 3.1	▼ -6.71	▼ -23.06
4.2	<i>Telefonia mobile</i>	141,515,795	169,488,400	188,206,585	199,243,326	▼ -19.76	▼ -32.99	▼ -40.79
4.3	<i>Linjat me qira</i>	728,382	403,712	1,138,573	1,628,849	▲ 44.57	▼ -56.31	▼ -123.6
4.4	<i>Qasja në internet</i>	23,579,370	21,250,329	19,755,654	18,606,407	▲ 9.87	▲ 16.21	▲ 21.09
5	Investimet (€)	53,267,460	35,378,366	35,935,977	38,240,000	▲ 33.58	▲ 32.53	▲ 28.11

Burimi: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP

TABELA 02 TË ARDHURAT E SEKTORIT TË TELEKOMIT NË VENDET E BE-SË

	Norma e rritjes 2010/2011	Norma e rritjes 2011/2012	Ndarja në të hyrat e shërbimeve e-comms
Zëri fiks dhe qasja në internet dhe shërbimet (Fixed voice and internet access services)	-2.2%	- 1.1%	39%
▶ Zëri fiks	-7.2%	-7%	24%
▶ Qasja në internet dhe shërbimet	2%	2.4%	15%
Telefonia mobile e bazuar në zë dhe telefonia mobile e bazuar në shërbimet e të dhënave (Mobile voice telephony and mobile data services)	-1%	0.4%	54%
▶ Telefonia mobile e bazuar në zë	-4.4%	-2.7%	34%
▶ Shërbimet e të dhënave nga mobili	6.3%	6.3%	19%
Shërbimet data të biznesit (Business data services)			
Shërbimet totale të telekomit (carrier services)			

Burimi: Shërbimet e EC bazuar në European Information Technology Observatory - EITO (2012)

FIG. 05 TOTALI I TË HYRAT NGA SHËRBIMET E TELEKOMIT NË EVROPË (PËRFSHIRË REPUBLIKËN E TURQISË DHE PËRJASHTUAR, RUSINË DHE UKRAINËN) (MLD €)







FIG. 06 ECURIA E TË ARDHURAVE NGA SHËRBIMET E TELEKOMIT NË EVROPË (PËRFSHIRË REPUBLIKËN E TURQISË DHE PËRJASHTUAR, RUSINË DHE UKRAINËN) (MLD€)



Burimi: European Telecommunication Network Operators - ETNO, Annual Report 2014



ARKEP-i, në tetor të vitit 2013, merr vendim lidhur me liberalizimin e mëtutjeshëm të shërbimeve duke lejuar kështu ofrimin e shërbimeve të avancuara mobile brezgjëra, 3G dhe 4G.

3. PROKURIMI PUBLIK: PROCEDURA TË STËRZGJATURA DHE ME NDIKIM NEGATIV

Sfidë domethënëse për kompanitë publike, e në këtë rast për PTK-në, krahas përballjes me ndryshimet dinamike në fushën e teknologjisë, është ballafaqimi me procedurat e stërzgjatura dhe shpeshherë të rënda të prokurimit publik. Procedurat e prokurimit publik, jo vetëm që konsumojnë shumë kohë, por edhe prolongojnë planet e investimit, duke i pamundësuar kështu ndërmarrjes reagimin e shpejtë në një treg jo vetëm konkurrues, por edhe me ndryshime teknologjike dinamike.⁷ Ky fakt mund të ilustruhet më së miri me përvojën e fundit të PTK-së, konkretisht me planet për ta futur në shërbim gjeneratën e re të teknologjisë të shërbimeve mobile brezgjëra të njohura si shërbimet 3G dhe 4G/LTE.

ARKEP-i, në tetor të vitit 2013, merr vendim lidhur me liberalizimin e mëturjtjeshëm të shërbimeve duke lejuar kështu ofrimin e shërbimeve të avancuara mobile brezgjëra, 3G dhe 4G.⁸ Ky vendim sipas ARKEP-it do të ishte i plotfuqishëm dhe efektiv për shfrytëzim komercial nga data 1 dhjetor 2013.

Në këtë kuadër, PTK-ja, për më shumë se një vit, e kishte të pamundur ta fus në shërbim teknologjinë 3G/LTE si pasojë në një anë e pezullimit të investimeve duke qenë se PTK-ja ishte në prag të transformimit të pronës (privatizimit), por në anën tjetër edhe për shkak të një ankese të bërë nga një kompani⁹ rreth procedurave të prokurimit publik. Vetëm në fund të vitit 2014, pasi që Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), nuk mundi të vendosë rreth kësaj ankese si pasojë e mungesës së anëtarëve të Bordit, PTK-së iu bë e mundur vazhdimi me procedurat e prokurimit.¹⁰ Kjo kishte ndodhur edhe pasi që Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), kishte vendosur që t'i

lejonte PTK-së, investime publike dhe kështu u bë i mundur lëshimi në përdorim i shërbimeve brezgjëra 3G.¹¹ Në anën tjetër, rivali kryesor në telefoni mobile i kompanisë mobile, IPKO, tashmë kishte një vit që kishte futur në përdorim shërbimet mobile 3G.¹²

Gjithsesi, zhvillimet teknologjike sidomos ato në fushën e telekomunikimeve përgjatë viteve kanë dëshmuar se operatorët në pronësi private kanë përparësi kompetitive, pasi që ato më lehtë i adaptohen zhvillimeve dhe dinamikave të ndikuara nga transformimet e reja teknologjike duke i përvetësuar ato shumë më shpejt dhe më lehtë. Megjithatë, pengesat e lartshënuara si ato të zhvillimit të teknologjisë së komunikimeve (OTT), por edhe procedurat e prokurimit publik, kanë pasur dhe do të kenë ndikim në punën e PTK-së, posaçërisht në përballimin e konkurrencës shumë të ashpër të dy operatorëve privat të cilat po ia vështirësojnë kompanisë mbajtjen dhe rritjen e numrit të konsumatorëve të rinj. Por, një ndikim shumë të theksuar për sa i përket rënies së vlerës së gjithëmbarshme të PTK-së, duhet t'i adresohet edhe ndërhyrjeve shumë të ashpra politike, atyre të ardhura nga industria e telekomunikacionit, si dhe praktikave shumë të shprehura të nepotizmit.

Përgjatë një harku kohor prej gjashtë viteve (2008-2013), disa zhvillime kontroverse kanë përcjellë operimin e PTK-së. Këto zhvillime përfshijnë: **a)** politizimin e strukturave vendim-marrëse dhe menaxhuese në PTK; **b)** punësimin e paplanifikuar në asnjë plan të biznesit të qindra individëve në PTK; **c)** ngritjen e nivelit të përgjithshëm të pagave më 2010, në kuadër të vitit nacional zgjedhor; **d)** vendimi i Qeverisë për pezullim të investimeve kapitale në PTK, dhe **e)** procesi i stërzgjatur dhe në fund i dështuar i tentimit të transformimit të pronës (privatizimit) të PTK-së.

7 Shih Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike; "Raporti Vjetor i Performancës së Ndërmarrjeve Publike"; faqe 34; 2012. http://mzhe.rks-gov.net/npmnp/repository/docs/Raporti_Vjetor_i_Performances_se_Ndermarrjeve_Publike_2012.pdf

8 ARKEP; Vendimi nr.400 për Liberalizimin e mëturjtjeshëm të shërbimeve mobile brezgjëra përmes lejit të përdorimit të teknologjive të reja që mundësojnë shërbimet e avancuara mobile. Tetor 2013. <http://arkep-rks.org/?cid=1,26,673>

9 Gazeta Jnk; Petrir Çollaku; "Ankesa Misterioze dhe mungesa e 3G-së së VALA-s"; 31.03.2014. <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,7926>

10 Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, vendimi 174/14; <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2014/konk-i-pergjithshem.pdf>

11 Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës; "Vala fillon me 3G/4G"; Nëntor 2014. <http://www.ptkonline.com/ptk/vala-3g-4g/61/>

12 Shih kohën e lancimit të rrjetit 3G nga IPKO. <http://www.ipko.com/rreth-ipko/marredhenie-me-publikun/historiku-i-ipko-se> <http://www.ipko.com/rreth-ipko/mbuluesmeria-me-3g>



Deri para shpalljes
së pavarësisë së vendit
më 2008, PTK-ja ishte nën
menaxhim të Agjencionit
Kosovar të Mirëbesimit (AKM),
ku më pas ndërmarrja kalon në
pronësi publike me Qeverinë e
Kosovës aksionarin e
vetëm të saj.

4. POLITIZIMI I STRUKTURAVE VENDIM-MARRËSE NË PTK

Analiza e trendit përkitazi me rënien e të hyrave por edhe të përdoruesve të telefonisë mobile të PTK-së, duhet të përcillet me një ekzaminim të thuktë të kontekstit në kuadër të të cilit ndërmarrja ka funksionuar, përfshirë këtu edhe vendimet që janë marrë dhe kanë afektuar punën e saj.

Duke qenë ndërmarrja më fitimprurëse në vend, PTK-ja ka qenë burim i mirë për shtrirjen dhe konsolidimin e ndikimeve partiake - patronazhit politik - por edhe për kultivimin dhe konservimin e një kulture nepotiste, dhe në këtë kuadër shihet qartë se ndërmarrja është shfrytëzuar në tri aspekte të ndryshme nga partitë politike, posaçërisht nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). E para, nga të dhënat e hulumtuara faktohet se PTK-ja ka shërbyer si qendër e punësimit për qindra individë duke ndihmuar kështu konsolidimin dhe forcimin e bazave elektorale të partive politike. E dyta, PTK-ja del të jetë në mesin e ndërmarrjeve publike ndër më të politizuara, ku në strukturat e saja vendim-marrëse dhe menaxhuese kanë qenë dhe janë të vendosur anëtarë kryesisht të PDK-së, por edhe të partive tjera.¹³ E treta, hulumtimi ka bërë të qartë se PTK-ja ka shërbyer edhe si burim i financave për donatorë të partive të ndryshme politike duke forcuar kështu një marrëdhënie klienteliste tek partitë politike.

Deri para shpalljes së pavarësisë së vendit më 2008, PTK-ja ishte nën menaxhim të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM), ku më pas ndërmarrja kalon në pronësi publike me Qeverinë e Kosovës aksionarin e vetëm të saj. Nga kjo kohë, strukturat menaxhuese, anëtarë të BD, si dhe zyrtarët e tjerë të lartë të PTK-së, kanë qenë në të njëjtën kohë edhe anëtarë aktiv të partive politike.

Ligji për Ndërmarrje Publike (NP),¹⁴ i cili mes tjerash rregullon edhe çështjen e përzgjedhjes së anëtarëve të BD të NP, nuk e specifikon qartë çështjen e pavarësisë së këtyre Bordeve gjë që është konsideruar edhe ndër të metat krye-

sore të tij.¹⁵ Ligji përcakton se personat të cilët në tri vitet e fundit janë zgjedhur në pozita publike, të emëruar politik apo mbajnë pozita vendim-marrëse në një parti politike,¹⁶ nuk mund të zgjedhën si anëtarë të bordit. Sidoqoftë, Ligji nuk e parasheh se çka ndodhë me kandidatët të cilët kanë garuar për poste publike por që nuk kanë arritur të zgjedhën. Në këto raste, edhe pse këta individë kanë dështuar të zgjedhën, pavarësia e tyre mbetet në pikëpyetje.

Ekipi hulumtues i këtij raporti ka arritur të nxjerr në pah se pozita të larta vendim-marrëse dhe menaxhuese në kuadër të PTK-së kanë qenë dhe janë të okupuara nga anëtarë të partive politike. Që nga transformimi i PTK-së në ndërmarrje publike më 2008 dhe deri më tani, në krye të BD të saj ka qenë një ish këshilltar komunal në qytetin e Pejës dhe anëtar i PDK-së.¹⁷ Anëtarët aktual të BD të PTK-së, katër nga gjithsej gjashtë janë anëtarë të PDK-së, kurse një i AKR-së, dhe një duket të jetë nga Partia e Pavarur Liberale (SLS).¹⁸ Hulumtimi i Çohu-ut nxjerr në pah se në 16 pozita të larta menaxhuese si: drejtorë departamentesh, auditor të brendshëm deri te pozitat vendim-marrëse si ato të zëvendës kryeshefit dhe të drejtorëve ekzekutiv të operatorit 'Vala' dhe të 'Posta e Kosovës', janë të punësuar anëtarë aktiv të partive politike, ku PDK-ja prinë me 12 sosh.¹⁹ Në fakt, të

15 Instituti Riinvest, "Qeverisja Korporative në Ndërmarrjet Publike në Kosovë"; 2012. <http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/alb-u.pdf>

16 Shih Ligji për Ndërmarrje Publike 03/L-087; Neni 17; Kushtet e Kualifikimit dhe Përshtatshmërisë Profesionale; k) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendim-marrës në një parti politike. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2547>

17 Gazeta JnK; "PDK Ruan Kontrollin në PTK"; Parim Olluri dhe Mirmoza Kqiku; Shkurt, 2015. <http://www.gazetajnk.com/?cid=1,2,9647>


18 **Regjë Gjonbalaj**, kryesues i Bordit, ish-këshilltar komunal i PDK-së në komunën e Pejës. Anëtar i degës së PDK-së në Pejë. Kandidat për deputet nga PDK, më 2007. **Gani Sylaj**, anëtar i Bordit, ish-kryetar i Komunës së Drenasit (2002-2005). Kryetar i degës së PDK-së, për Drenas dhe anëtar i Këshillit Drejtues i PDK-së. **Afrim Loku**, anëtar i Bordit, kandidat për deputet i AKR-së më 2007, dhe kandidat për kryetar të Komunës së Kaçanikut, më 2009. **Bislim Zogaj**, anëtar i Bordit, kandidat nga PDK-ja për Asamble Komunale në Drenas në vitin 2013. Kandidat për deputet në vitin 2014. Anëtar i kryesisë së PDK-së në Drenas. **Naim Hyseni**, anëtar i Bordit, asamblist në Kuvendin Komunal në Vushtrri më 2007 dhe 2009. Kandidat për deputet i PDK-së më 2010.

19 Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtues - Preportr; Besa Kalaja dhe Besnik Boletini; "Partia e Punës"; nr 10; Dhjetor 2014. <http://www.preportr.com/sq/Re-publika/Partia-e-puns-389>

13 Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtues - Preportr; Besa Kalaja dhe Besnik Boletini; "Partia e Punës"; nr 10; Dhjetor 2014. <http://www.preportr.com/sq/Re-publika/Partia-e-puns-389>

14 Shih Ligji për Ndërmarrje Publike 03/L-087, i amendamentuar me Ligjin 04/L-111. <https://gzk.rks-gov.net/SearchIn.aspx?Index=2&s=ndermarrjet%20publike&so=1>

FIG. 07 VLERA TOTALE E TENDERËVE TË FITUAR NGA FINANCUESIT E PARTIVE POLITIKE



gjithë drejtorët ekzekutiv pas transformimit të PTK-së në ndërmarrje publike - 4 gjithsej - kanë qenë ose anëtarë aktiv të PDK-së, ose shumë të afërt me këtë parti, përfshi këtu edhe drejtorin ekzekutiv të PTK-së të emëruar së fundi.²⁰ Madje në një rast, ish drejtori ekzekutiv i PTK-së, Ejup Qerimi, deri sa ushtronte pozitën e drejtorit ekzekutiv në ndërmarrje kishte kandiduar edhe për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës në zgjedhjet e fundit nacionale të viti 2014. Ai kishte deklaruar se: “varet nga kërkesat e partisë se a do ta lëshoj pozitën e drejtorit ekzekutiv në PTK, në rast se zgjidhem deputet”,²¹ duke ekspozuar kështu ndikimin shumë evident dhe të drejtpërdrejt të partisë në menaxhimin ditor të ndërmarrjes.

Në kuadër të këtij hulumtimi dhe me qëllim të zbardhjes së shpërndarjes së tenderëve publik me vlerë të madhe nga PTK-ja, ekipi hulumtues ka arritur të faktoj se shuma të larta të parave u kanë shkuar kompanive të ndryshme, të cilat sipas të dhënave të Raporteve Financiare të Auditit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ),²² janë financues të

partive të ndryshme politike. Nga të dhënat është arritur të dëshmohet se më shumë se 23 milionë euro²³ nga tenderët publik me vlerë të madhe u janë shpërndarë kompanive të ndryshme të cilat kanë financuar pesë subjekte politike.

Për më shumë, gjatë kësaj pjese të hulumtimit është bërë e mundur që të identifikohen edhe kontrata tjera të qiradhënies me vlera deri në 1000 mijë euro në muaj që u janë dhënë po ashtu donatorëve të partive politike. Këto kontrata u referohen Stacioneve Transmetuese Bazë (**Base Transceiver Station**), ku individë të ndryshëm lëshojnë pjesë të pronave të tyre për instalimin e antenave transmetuese.

Ka pasur edhe raportime tjera të medias, përkritazi me përfitimin prej 1.8 milionë euro të një kompanie e cila kishte lidhje evidente me kryetarin e Bordit të PTK-së, drejtorin e saj ekzekutiv si dhe drejtuesin e njësisë së prokurimit publik.²⁴

²⁰ Drejtori i porsazgjedhur i PTK, Agron Mustafa, është anëtar i Partisë Demokratike të Kosovës, dega në Prishtinë. Ish drejtori i fundit ekzekutiv i PTK-së, Ejup Qerimi, i shkarkuar së fundi me vendim të Bordit, i cili drejtoi ndërmarrjen për dy vite, si dhe kryetari i tashëm i Bordit të ndërmarrjes, janë anëtarë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), përderisa njëri nga dy drejtorët ekzekutiv paraprak të PTK-së ka qenë i afërt me PDK-në, madje njëri edhe kandidat i kësaj partie për deputet në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2007. Shih: Gazeta Jeta në Kosovë; “Kryeshefi i PTK-së, kuadër i PDK-së”; Parim Olluri; Shkurt, 2012.. <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,1458>

²¹ Shih Jeta në Kosovë; minuta 1:00:35. <https://www.youtube.com/watch?v=g-9mTjFDBTq4&list=UURat2HLLgb78NvskMILQMw>

²² Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - Raportet Financiare të Auditit. <http://www.kqz-ks.org/en/financial-reports-and-audit>

²³ Ekipi hulumtues ka nxjerrë dhe analizuar më shumë se 180 kontrata me vlerë të madhe që janë nënshkruar nga PTK-ja, dhe nga këto të dhëna ka krijuar një databazë me të dhëna të kompanive që kanë përfituar nga këta tenderë. Këto të dhëna janë krahasuar me Raportet Financiare të Auditit të KQZ-së, nga cili krahasim dhe analizim kemi arritur të identifikojmë një vlerë prej 23,441,257 milionë euro që u janë shpërndarë 10 kompanive të ndryshme që janë financuese të 5 partive politike.

²⁴ Gazeta JnK; Parim Olluri and Petrit Qollaku; “Milionshi i negociuar”; 07.07.2014. <http://www.gazetajnk.com/?cid=1,987,8622>

5. PUNËSIMI DHE PËRFITIMET PARTIAKE

Duke mos u bazuar në asnjë dokument strategjik apo plan të biznesit, më 2008, kohë kur kishte ndodhur ndryshimi i qeverisë në vend dhe në krye të saj kishte ardhur koalicioni PDK-LDK²⁵ dhe përgjatë dy viteve në vijim, në PTK u punësuan më shumë se 820 individë.²⁶

Raporte të ndryshme të mediave kishin vënë në pah se zyrtarë politik si kryetari i shtetit, kryeministri, ministra e deputetë të koalicionit qeverisës, por edhe zyrtarë të tjerë publik të nivelit të lartë kishin punësuar familjarë të tyre në PTK duke e shtrirë dhe ngurtësuar një kulturë nepotizmi në ndërmarrjen publike.²⁷ Kur kishin filluar hetimet penale kundër ish-drejtorit ekzekutiv të PTK-së, Shyqyri Haxha, rreth akuzave për nënshkrim të kontratave të dëmshme në emër të ndërmarrjes, ky për herë të parë kishte deklaruar para gjykatës se kishte pasur presione politike për punësime në PTK.²⁸

Krahas këtij vendimi, i cili mbingarkoi kompaninë me staf të panevojshëm, më 2010 - vit zgjedhor nacional - PTK-ja mori një tjetër vendim. Përveç punësimit të 179 individëve më 2010, PTK rriti shpenzimet për paga për stafin drejtues të saj.²⁹

25 Më 2007, në zgjedhjet e përgjithshme në vend, Partia Demokratike e Kosovës, për herë të parë doli partia më e madhe në Kosovë dhe së bashku me Lidhjen Demokratike të Kosovës, partia e dytë për nga numri i votuesve, formuan koalicionin qeverisës.

26 Shih Raportet vjetore financiare të PTK-së; <http://www.ptkonline.com/ptk/publications/>

27 Koha.net; "Familjarët e politikanëve të punësuar në PTK"; 14.09.2011. <http://koha.net/arkiva/?page=1,3,69279>

Koha.net; "Gratë e PDK-së në Gjilan i dalin në krah gruas së Mustafës, e punësuar në PTK"; 12.06.2014. <http://koha.net/?id=27&l=13933>

Reporter.net; "Ja ku i punësojnë familjarët njerëzit e PDK-së dhe LDK-së";

27.05.2014. <http://reporteri.net/?page=1,2,18979>

Gazeta Zëri; Lavdim Hamidi; "Shala punëson "kushat" në PTK"; 01-09-2010.

28 Shih: Gazeta Zëri; Arsim Rashiti; "Haxha: Kam presion politik"; 15.07.2010.

29 Sipas drejtorit ekzekutiv të PTK-së, Agron Mustafa, vendimi për rritje të shpenzimeve për paga ishte më shumë taktik, sesa i karakterit politik. Në vitin 2010, QeK kishte marrë vendim për fillimin e procesit të transformimit të pronës së PTK-së -privatizimin e ndërmarrjes- dhe në këtë kuadër, rritja e pagut mesatar të nivelit të pagave ishte më shumë vendim preventiv qëllimi i të cili ishte vendosja e inves-

Vendimi për rritje të shkallës së pagave të stafit drejtues të PTK-së, jo vetëm se erdhi në kohën kur kompania po shënonte rënie në të hyrat e saja, dhe si i tillë nuk ishte paraparë në planet e biznesit të ndërmarrjes, por ishte edhe në kundërshtim të plotë me vendimin e

Qeverisë së Kosovës (QeK), e cila kishte vendosur për ngrirje gjithëpërfshirëse të nivelit të pagave, ndalim të punësimit të punonjësve të rinj, si dhe kishte stopuar investimet kapitale dhe shpenzimet e ardhshme.³⁰

Ky vendim i PTK-së, krahas rritjes së pakontrolluar të numrit të të punësuarve dhe pamundësisë së ndërmarrjes për t'u bërë ballë dy rivalëve të saj kryesor, IPKO dhe Z-Mobile, pashmangshëm krijoi shpenzime shtesë dhe shteroi tashmë edhe më tepër të hyrat e kompanisë.

Në kuadër të këtij cikli, pra të ofrimit të shpërblimeve të paplanifikuara dhe të pakontrolluara të cilat në disa raste

kishin prapavijë të qartë partiake, drejtuesit e PTK-së përgjatë viteve 2009-2012 kishin ofruar benefite të ndryshme edhe për Bordin e Drejtorëve (BD) në formë të bonuseve dhe honorarëve në shumën mbi 600 mijë euro.³¹

Sipas raportit të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), të vitit 2014, kishte edhe tejkalime në pagesa për bonuse ku për vitin 2010 tejkalimi ishte për 59,129


titorit të ardhshëm para aktit të kryer në rast të privatizimit të ndërmarrjes. Individ tjerë brenda PTK-së, kanë konfirmuar se më 2010, nuk ka pasur rritje të pagut mesatar të pagave të stafit, por PTK-ja ka rritur vetëm pagat e stafit drejtues të ndërmarrjes si dhe kjo rritje e shpenzimeve në paga reflekton edhe pjesën e rritjes së numrit prej 179 të punësuarve të ri gjatë viti 2010.

30 Vendimi i Qeverisë së Kosovës, 5/124, i cili parashihte ndaljen e investimeve të ardhshme, të punësimit si dhe të nivelit të pagave në PTK. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_124-te_te_Qeverise_2010.pdf

31 Zyra e Auditorit Gjeneral; "Raporti i Auditimit për kompensimin e Bordeve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore për periudhën 2009-2012"; Gusht 2014. http://www.oag-rks.org/repository/docs/KompensimetBordetDrejtor-eve_2013_Shqip_813917.pdf


FIG. 08 TRENDI I PUNËSIMIT NË PTK (2008-2013)

Vala  PTK sh.a 




Burimi: Të dhënat e marra nga raportet vjetore financiare të PTK-së (2008 - 2013)

FIG. 09 TRENDI I NGRITJES SË NIVELIT TË PAGAVE NË PTK



Burimi: Të dhënat e marra nga raportet vjetore financiare të PTK-së (2008 - 2014)

FIG. 10 BONUSET DHE HONORARET PËR BORDIN TË DREJTORËVE TË PTK-SË DHE KOMITETET TJERA (2009-2012)



Burimi: Zyra e Auditorit Gjeneral - Raporti i Auditimit për kompensimin e Bordeve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore për periudhën (2009-2012)



euro, përderisa në vitin 2011 tejkalimi ishte për 60,249 euro.³² Raporti i ZAP, tërheq vëmendjen se shumica e ndërmarrjeve publike (NP), përfshirë këtu edhe PTK-në, nuk kanë arritur që të vendosin kritere të matshme në deklaratat e kompensimit përmes të cilave do të bëhej vlerësimi i performancës mbi bazën e të cilave do të përfitohej drejta në bonuse për BD. Po ashtu, sipas raportit të ZAP, kriteret e vendosura në shumicën e deklaratave për pagesa stimuluese kanë të bëjnë me punë të rregullta të cilat ju takojnë BD-ve dhe si të tilla do të duhej paguar sipas honorarit themelor e jo përmes bonuseve.³³

Drejtues të PTK-së nuk kanë ofruar qasje në planet e biznesit apo projeksionet e kompanisë për vitet 2009 dhe 2010 për të mundësuar një analizë më të saktë se mbi çfarë baze janë marrë vendimet për rritje të nivelit të pagave si dhe për shpërndarje të bonuseve dhe beneficioneve për anëtarët e BD dhe për Komitetet tjera të PTK-së. Planet e biznesit si dhe raportet vjetore të PTK-së, për vitet e lartë shënuara nuk janë të publikuara as në faqen elektronike të Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP).³⁴

³² Po aty, faqe 11.

³³ Po aty, faqe 9.

³⁴ Shih tërë dokumentacionin i cili është bërë publik nga Njësia për Politika dhe Monitorim të ndërmarrjeve Publike (NJPMNP). <http://mzhe.rks-gov.net/npmn-p/?page=1,265>



Të dhënat e ARKEP-it për tre mujin e fundit për vitin 2014, tregojnë se rënia në të hyra që do të shënojë PTK-ja do të jetë më e larta krahasuar me të gjitha vitet paraprake.

6. EFEKTET NEGATIVE TË PEZULLIMIT TË INVESTIMEVE NË PTK

Më 2011, duke se PTK-ja po rimerрте vetën pas një rënije të vazhdueshme gjatë tri viteve paraprake duke gjeneruar më shumë se 162 milionë euro, pika më e lartë e të hyrave që nga viti 2007. Në këtë vit, PTK-ja gjeneroi 11 milionë euro më shumë se në vitin 2010, dhe më shumë se 17 milionë euro krahasuar me vitin 2009.³⁵ Me këtë trend u duk që PTK-ja po përfundonte ciklin e rënies së vazhdueshme duke u kthyer në pozicionin e saj më të mirë që nga hyrja e operatorit të dytë të telefonisë mobile në treg. Sidoqoftë, duhet theksuar se kjo rimëkëmbje e PTK-së nuk ka qenë rezultat i përmirësimit të politikave menaxhuese të kompanisë apo të ndonjë ndryshimi cilësor në orientimin strategjik të saj. Kjo rritje e të hyrave të PTK-së, në fakt ka qenë rezultat i


drejtpërdrejtë i një vendimi të Qeverisë së Kosovës e cila më 2010 vendosi për fillimin e transformimit të pronës së PTK-së (privatizimin),³⁶ dhe si rrjedhojë e këtij procesi pati marrë po ashtu vendim për ngrirjen e të gjitha investimeve dhe shpenzimeve të ardhshme, pezullim të rritjes së numrit të të punësuarve, si dhe ndaloi ngritje të nivelit të pagave në PTK.³⁷ Në këtë kuadër, pra të pezullimit të investimeve kapitale por edhe të ndalimit të shpenzimeve tjera duhet të shihet 'suksesi' i PTK-së përkitazi me rritjen e të hyrave në vitin 2011.

35 Plani i Biznesit i PTK-së (2015-2019), po ashtu e vë theksin në efektet negative që kanë rrjedhur nga ndalja e investimeve në kompani, duke nënvizuar se kjo mungesë është shfrytëzuar në mënyrë të efektshme nga dy operatorët tjerë konkurrent. Plani i biznesit i PTK-së, (2015-2019). http://mzhe.rks-gov.net/npmnp/repository/docs/Plani_i_Biznesit_2015_PTK_sha.pdf

36 Vendimi i Qeverisë së Kosovës 01/130 rreth privatizimit të 75% të aksioneve në PTK. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_130-te_te_Qeverise_2010.pdf


37 Vendimi i Qeverisë së Kosovës 5/124, i cili ndalon investimet dhe shpenzimet e ardhshme, rritjen e numrit të punësuarve, si dhe ngrijen e nivelit të pagave në PTK. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_124-te_te_Qeverise_2010.pdf

FIG. 11 TRENDI I INVESTIMEVE NË PTK (2007-2014)



Burimi: Të dhënat e marra nga raportet vjetore financiare të PTK-së (2008 - 2014)

FIG. 12 TË HYRAT E PTK-SË PËR VITIN 2014 (T1-T4)



Burimi: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP

Përkundër faktit që në vitin 2011, PTK-ja shënoi rritje rekorde në të hyra krahasuar me dy vitet paraprake, cikli i tkurrjes së të hyrave të përgjithshme që kishte filluar në vitin 2008 do të vazhdonte në vitet pasuese. Duke qenë se nga viti 2010 deri në fund të vitit 2013, QeK tentoi dy herë ta privatizonte PTK-në,³⁸ vendimi për pezullim të investimeve qëndroi i plotfuqishëm përgjatë këtyre tri viteve duke reflektuar negativisht në të hyrat e kompanisë në vitet vijuese. Në vitin 2012 të hyrat e PTK-së, janë tkurrur për më shumë se 14.5 milionë euro, në vitin 2013 për 33 milionë euro ndërsa në vitin 2014, ato janë zvogëluar për 62.8 milionë euro krahasuar me vitin 2011.

Ndërhyrja shumë e fortë e qeverisë në menaxhimin ditor të kompanisë përmes punësimit të pa kriter të militantëve politik, të familjarëve të vendim-marrësve politik, bashkë me politizimin e skajshëm të strukturave menaxhuese të ndërmarrjes, por sidomos pezullimi i plotë i investimeve kapitale për më shumë se tri vite, janë ndër shkaqet kryesore që PTK-ja gjatë vitit 2014, shënon rënien më të madhe në të hyrat e saj gjatë gjithë historisë së funksionimit të ndërmarrjes.

Të dhënat e ARKEP-it për tre muajin e fundit për vitin 2014, tregojnë se rënia në të hyra që do të shënojë PTK-ja do të jetë më e larta krahasuar me të gjitha vitet paraprake.

Vendimi për pezullim të investimeve në PTK, krahas efekteve negative të drejtpërdrejta, ka pasur ndikime edhe të tërthorta. Vetëm disa ditë para se QeK, të merrte vendim për ndalje të investimeve, PTK-ja kishte nënshkruar një kontratë me "AMDOCS Development Limited", për sa i përket zhvillimit të platformës së faturimit me një shumë prej 19 milionë eurosh. Si pasojë e vendimit të Qeverisë, kontrata me AMDPCS ishte anuluar dhe PTK-ja është penalizuar me 10 milionë euro dëmshpërblim për prishje të kontratës.³⁹

Efektet negative të mungesës së investimeve kapitale ndikuan drejtpërdrejt edhe në rënien e penetrimit të shërbimit të internetit të PTK-së. Përderisa PTK-ja, kishte filluar të fitonte treg të përdoruesve të internetit nga 9.80% sa kishte në vitin 2007, duke arritur deri në 31.63% në vitin 2010, pas ndaljes së investimeve kapitale përqindja e këtij tregu në vitin 2014 ra në më pak se 19%. Kjo rënie e tregut të internetit në rritje është nënvizuar si shqetësuese edhe në Planin e Biznesit të PTK-së, për vitet 2015-2019.⁴⁰


³⁸ Shih vendimin e Komitetit Qeveritar të Privatizimit (KQP) për ta mbyllur procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së. <http://mzhe.rks-gov.net/?page=2,42,775>

³⁹ Rasti me AMDPCS është ende në procedurë ankimese. Shuma që PTK-ja është detyruar ta paguaj si dëmshpërblim për anulim të kontratës me AMDPCS është marrë nga raportet vjetore financiare, 2012-13. <http://www.ptkonline.com/ptk/raport/>

Sipas ish drejtorit ekzekutiv të PTK-së, Shyqyri Haxha, ndërprerja e kontratës për zhvillimin e platformës së faturimit do t'i sillte kompanisë humbje shtesë duke qenë se ia pamundësonte konkurrencën me rivalët e saj. Shih: Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese - Preportr; "Tenderi që ekspozoi kapjen e qeverisë"; 23.11.2011. <http://www.preportr.com/sq/Asetet-publike-dhe-privatizimi/Tenderi-q-ekspozoi-kapjen-e-qeveris-52>


⁴⁰ Plani i biznesit i PTK-së, (2015-2019). http://mzhe.rks-gov.net/npmnp/repository/docs/Plani_i_Biznesit_2015__PTK_sha.pdf

FIG. 13 TË HYRAT E OPERATORËVE TË TELEFONISË MOBILE PËR PERIUDHËN (2011- 2014)




Burimi: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP

FIG. 14 NDARJA E TREGUT TË INTERNETIT (NË %) SIPAS PËRDORUESVE - PËRQINDJA MESATARE VJETORE (2007-2014)



Burimi: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP

FIG. 15 NDARJA E TREGUT TË INTERNETIT (NË %) SIPAS TË HYRAVE - PËRQINDJA MESATARE VJETORE (2012-2014)



Burimi: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP

Për disa vite IPKO, kishte shfrytëzuar rrjetin e fijeve optike të PTK-së dhe me këtë kishte arritur të konsolidonte shtrirjen e internetit dhe të televizionit kabllor. Më 2011, PTK-ja kishte provuar që në mënyrë të njëanshme të ndërpriste kontratën me IPKO-në,⁴¹ vendim ky që ishte konsideruar se i rrezikon shërbimet e IPKO-së. Kjo nismë e PTK-së ishte anuluar nga ARKEP-i nën arsyetimin se PTK-ja nuk ka arritur të arsyetoj këtë vendim dhe ka dështuar që të: "dokumentojë gamën e shërbimeve që dëshiron të përdorë dhe nuk ka arsyetuar kapacitetet e nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve".⁴² Sidoqoftë, PTK-ja, asnjëherë nuk ka bërë të ditur se mbi cilin plan të biznesit ishte paraparë strategjia e investimit të milionave euro në shtrimin e rrjetave të fibrave optike dhe të njëjtat të mos përdoren për zhvillim të mëtutjeshëm të ndërmarrjes (PTK-së), por kjo infrastrukturë t'i jepen me qira operatorit rival, IPKO, e cila përmes tyre arriti të sigurojë zhvillim dhe rritje të tregut të televizionit kabllor dhe internetit.

Nga viti 2012 operatori IPKO, nuk e shfrytëzon infrastrukturën e fibrave optik të PTK-së, përderisa kjo e fundit, sipas ARKEP-it, ka mjaftueshëm edhe sot fije optike të pashfrytëzuara. Bazuar në të dhënat e ARKEP-it, në Kosovë ka katër infrastruktura fikse nacionale të fibrave optike të shtrira, kurse ka shfrytëzim të përbashkët simbolik të tyre. Në këtë kuadër, Banka Botërore (BB), në fund të vitit 2014 ka miratuar një projekt i cili ka për qëllim lehtësimin e shfrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës në Kosovë, i cili pritet të zbatohet gjatë vitit 2015.⁴³

Nga të gjitha shërbimet që ofron PTK-ja, ndërmarrja ka pasur dhe vazhdon të ketë monopol në telefoninë fikse, por të hyrat nga ky shërbim janë disproporcionalisht më të ulëta se sa të hyrat nga telefonia mobile.


41 Ekipi hulumtues i këtij raporti ka arritur të siguroj qasje në vendimin e PTK-së për ndërprerje të kontratës me IPKO-në, rreth shfrytëzimit të fijeve optike. Shih po ashtu: Koha.net; "PTK s'u "shkurorëzua" nga IPKO-ja"; 21.07.2011. <http://koha.net/arkiva/?page=1,3,63368> Kosova Press; "'Rrezikohen shërbimet e IPKO-s , PTK i ndërprente kontratën"; 26.05.2011. (e qasur më Dhjetor 2014) <http://www.kosovapress.com/archive/?cid=1,26,128527>

42 Shih vendimin e ARKEP për anulimin e iniciativës të njëanshme të PTK-së rreth ndërprerjes së kontratës me IPKO, mbi shfrytëzimin e fijeve optike. <http://www.arkep-rks.org/repository/docs/Vendimi%20i%20Komisionit%20-%20Ceshtja%20e%20Nderprerjes%20se%20Kontrates%20per%20Fijet%20Optike%20-%20IPKO%20vs%20PTK.pdf>



43 Komunikim përmes postës elektronike me kryetarin e Bordit të ARKEP, z. Ekrem Hoxha.

FIG. 16 NDARJA E TREGUT TË TELEFONISË FIKSE -
PËRQINDJA MESATARE VJETORE (2007-2014)

PTK IPKO



Burimi: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP



Më 2008, PTK-ja do të arrinte një marrëveshje paraprake me OVTM të quajtur 'Dardafone LLC' rreth shfrytëzimit të infrastrukturës dhe frekuencave GSM të kompanisë publike.

7. NDIKIMI INDUSTRIAL NË TREGUN E TELEFONISË: KONTRATA ME Z-MOBILE

Njëri nga zhvillimet kryesore në fushën e telefonisë mobile që në diskursin publik është konsideruar si rast i ndikimit industrial dhe politik konsiderohet nënshkrimi i marrëveshjes për Operator Virtual të Telefonisë Mobile (OVTM), nga PTK-ja, e që tash në treg operon me emrin komercial, 'Z-Mobile'.

Duke qenë se pas vitit 2007, PTK-ja për herë të parë filloi të ballafaqohet me konkurrencë shumë të ashpër në tregun e telefonisë mobile, njëra ndër mënyrat për ta përballuar atë ishte ofrimi i këtyre shërbimeve përmes OVTM-së. Më 2008, PTK-ja do të arrinte një marrëveshje paraprake me OVTM të quajtur 'Dardafone LLC'⁴⁴ rreth shfrytëzimit të infrastrukturës dhe frekuencave GSM të kompanisë publike.

Dy Task Forca, ishin krijuar nga PTK-ja për ta analizuar marrëveshjen me 'Dardafone LLC'. Task Forca 1 kishte propozuar që PTK-së t'i takonin 22% e fitimit, ndërsa 'Dardafone LLC', t'i takonin 78%. Duke qenë se kishte mos pajtime në BD të PTK-së rreth kushteve të propozuara nga Task Forca 1, ishte kërkuar një vlerësim i ri. Task Forca 2, kishte propozuar një ndarje të fitimit që ishte e kundërt me atë të parën, ku tash PTK-së do t'i takonin 73% e fitimit kurse 'Dardafone LLC' do t'i takonin 27%. Ky vlerësim i Task Forcës 2, nuk ishte pranuar nga BD i PTK-së, por ata kishin vendosur për nënshkrimin e marrëveshjes sipas kushteve të propozuara nga Task Forca 1, pa ndonjë argument të bazuar por evidencë faktike.⁴⁵

Marrëveshja finale parashihte një ndarje të fitimit jo të favorshme për PTK-në, ku 75% e tij do t'i shkonte 'Dardafone LLC', ndërsa 25%, PTK-së. Por, pas kritikave të shumta rreth kushteve jo të favorshme të kontratës për PTK-në, e tëra që u arrit ishte një ndryshim sipërfaqësor në nivelin e përqindjes së fitimit, ku PTK-ja morri 27%, pra një rritje

e përqindjes së fitimit për vetëm 2%, përderisa Z-Mobile, morri 73% të fitimit.⁴⁶

Pak para se të nënshkruhej kontrata formale në mes PTK-së dhe 'Dardafone LLC', edhe pse tashmë kishte një marrëveshje në mes këtyre dy kompanive, 'Dardafone LLC', kishte aplikuar dhe marrë licencë në ARKEP për të funksionuar si operator mobil virtual. Kjo licencë më vonë dhe atë me vendim të ARKEP-it, i ishte bartur një operatori të ri të quajtur 'Dardafone.net LLC',⁴⁷ me pronarë tashmë të ri, një hap i cili është konsideruar shumë kontrovers i Rregullatorit. Kompania e re e quajtur 'Dardafone.net LLC', e cila në treg operon me emrin 'Z-mobile', pretendonte se kishte blerë të gjitha aksionet e 'Dardafone LLC' dhe me këtë akt ishte bërë pronare e re e licencës së OVTM-së të lëshuar nga ARKEP-i. 'Dardafone.net LLC', ishte themeluar vetëm katër ditë para se të aplikonte në ARKEP për të transferuar licencën nga 'Dardafone LLC'.⁴⁸

Baza e kritikave të kësaj kontrate është fokusuar në nivelin shumë të ulët të përqindjes së fitimit që i takonte PTK-së. Një kontratë e tillë do të ishte e arsyeshme po që se PTK-ja, do të mbante pjesën më të madhe të aksioneve, marrë në konsideratë faktin se aksionarët në një nismë të përbashkët marrin përqindje në proporcion me kapitalin që e posedojnë. Këtu, PTK-ja posedonte frekuencat GSM si dhe infrastrukturën e domosdoshme për të bërë të mundur operimin e OVTM-së, dy nga shtyllat kryesore të kësaj marrëveshje. Marrë parasysh këtë fakt, ishte shumë e çuditshme se si PTK-ja nuk kishte tentuar të gjejë partnerë të tjerë dhe të tentojë

44 Kompania Dardafon LLC u krijua më 9 janar 2007 nga tri kompani të tjera, përkatësisht aksionarët e saj Unitel World me 48 për qind të aksioneve, Via One me 10 për qind si dhe Devolli Group Company me 42 për qind të aksioneve. Gazeta JnK; "Rasti Dardafon, Konfirmohet Pjesërisht Akuza"; 01.02.2012. <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,1256>
Gazeta JnK; Florent Spahija; "Rasti që Përfshinte Biznesin e Shtetin Nuk Pati Prova"; 02.07.2013. <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,5935>


45 Po aty.

46 Pasi që prokurorët e EULEX-it, patën filluar hetimet rreth kësaj kontrate, ish drejtori ekzekutiv i PTK-së, ndaj të cilit ishte nisur hetimi, kishte deklaruar për mediat vendore se ai ka arritur t'i shtojë 2% fitim PTK-së, nga marrëveshja paraprake e cila parashihte që PTK-së, t'i takonin vetëm 25% e fitimit me Dardafone LLC. Shih po ashtu: Gazeta JnK; "Haxha u Lutej Devollëve që ta Rrisnin Përqindjen"; Florent Spahija; Qershor, 2013. <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,5902>

47 Dardafon.net është krijuar më 21 nëntor 2008 apo katër ditë para aplikimit në ART dhe ishte në pronësi të Shkëlqim Devollit me 90 për qind të aksioneve dhe kompanisë amerikane K-Com me dhjetë për qind.

48 Gazeta JnK; "Rasti Dardafon, Konfirmohet Pjesërisht Akuza"; 01.02.2012. <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,1256>
Gazeta JnK; Florent Spahija; "Rasti që Përfshinte Biznesin e Shtetin Nuk Pati Prova"; 02.07.2013. <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,5935>

FIG. 17 NDARJA E TREGUT TË TELEFONISË MOBILE (NË %) SIPAS PËRDORUESVE NË TREMUJORËT E FUNDIT (T4 2007- T3-T4 2014)



Burimi: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP

të lidhë kontratë me kushte shumë më të favorshme për të.

Bazuar në dokumentet të cilat ekipi hulumtues i këtij raporti ka arritur t'i analizoj, shihet qartë se arsyeja kryesore që e ka shtyrë PTK-në, të mendojë për një operator virtual ka qenë parandalimi i procesit të 'kanibalizmit', të vetvetes. Kjo nënkupton, pikësëpari parandalimin e hyrjes në një cikël permanent të zbritjes së çmimeve të thirrjeve nga ana e operatorit mobil të PTK-së, dhe në këtë mënyrë dëmtimin e kompanisë në mënyrë të pariparueshme.

Siç duket nga dokumentacioni, synimi primar i PTK-së ka qenë që përmes një operatori virtual së pari të parandalohet kalimi i konsumatorëve të 'Vala'-së tek operatori privat IPKO, si dhe të arrihet më lehtë tek konsumatorët e rinj duke u bazuar në faktin se OVTM-të kanë kosto operative shumë më të lira dhe mundësi shumë më efektive të marketingut. Marrë parasysh që PTK-ja u tregua e pa-aftë për të përballuar konkurrencën e IPKO-së, ky hap edhe mund të ishte konsideruar si i domosdoshëm, veçanërisht nëse objektivat e caktuara nga ana e PTK-së do të ishin arritur.⁴⁹

49 Të njëjtin arsyetim rreth nënshkrimit të kontratës me 'Z-Mobile', e kanë dhënë edhe ish drejtori ekzekutiv i PTK-së, Shyqyri Haxha, i cili kishte nënshkruar kontratën, si dhe kryetari i BD të PTK-së, Rexhë Gjonbalaj, të cilët në kuadër të procesit gjyqësor kundër tyre dhe rreth nënshkrimit të kësaj kontrate, kishin deklaruar se kjo marrëveshje jo vetëm se do t'i ndalojë humbjet, por do ta rris edhe numrin e konsumatorëve. Për më shumë shih: Gazeta JnK; Florent Spahija; "Rasti që Përfshinte Biznesin e Shtetit Nuk Pati Prova"; 02.07.2013. <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,5935>


Të dhënat e ARKEP-it tregojnë se rritja e 'Z-Mobile', për sa i përket edhe përdoruesve të telefonisë mobile por edhe të hyrave, është bërë në kurriz të konsumatorëve të 'Vala', zhvillim krejt i kundërt nga parashikimi dhe pritjet fillestare. Brenda katër viteve të operimit, 'Z-Mobile' posedon afër 11% të tregut të përdoruesve të telefonisë mobile dhe rreth 6% të të hyrave nga ky treg. Siç edhe duket nga të dhënat e ARKEP-it, IPKO-ja, jo vetëm që ka arritur ta mbajë por në mënyrë lineare ka shënuar rritje në tregun e telefonisë mobile.

Fakti se rritja e 'Z-Mobile', ka ndodhur duke u bazuar ekskluzivisht në tregun e PTK-së, e jo në atë të IPKO-së, theksohet edhe në Planin e Biznesit të PTK-së (2015-2019), ku thuhet se: "Në 4 vite, operatori 'Z Mobile', **përvetësoi 11 % të tregut, po aq sa operatori 'Vala'** ka humbur në këtë periudhë të njëjtë".⁵⁰ Pra këto të dhëna tregojnë për trend krejt të kundërt nga ai që ishte pritur me nënshkrimin e kontratës me 'Dardafone.net LLC', ku ishte synuar që PTK-ja, jo vetëm të mbajë konsumatorët aktual, por edhe të fitojë të rinj.

Mund të argumentohet se në fakt nënshkrimi i marrëveshjes në mes PTK-së dhe 'Dardafone.net LLC', ka arritur të paktën një qëllim të synuar: parandalimin e kalimit të konsumatorëve të 'Vala'-së tek IPKO. Potencialisht, mund të thuhet që në rast të mos nënshkrimit të kontratës me 'Dardafone.net LLC', IPKO do

50 Plani i biznesit i PTK-së, (2015-2019). http://mzhe.rks-gov.net/npmnp/repository/docs/Plani_i_Biznesit_2015__PTK_sha.pdf

FIG. 18 NDARJA E TREGUT E TELEFONISË MOBILE (NË %) SIPAS TË HYRAVE NË TREMUJORËT E FUNDIT (T4 2007- T3 2014)



Burimi: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP

të mund të përfitonte pjesën e tregut prej 11% të përdoruesve të telefonisë mobile, aq sa sot zotëron 'Z-Mobile'. Në këtë skenar, PTK do të mund të humbiste edhe atë 27% të të hyrave që i gjeneron si pjesë e marrëveshjes me 'Dardafone.net LLC'.

Kontrata në mes tjerash parasheh që PTK-ja të marrë përqindjen e fitimit vetëm nga thirrjet (nga PTK-ja dhe nga operatorët e tjerë) që realizohen në drejtim të 'Z-Mobile' dhe anasjelltas, përderisa PTK-ja, nuk përfiton asgjë nga thirrjet që realizohen në kuadër të rrjetit të Z-mobile. Në këtë mënyrë, kontrata duket që më shumë ka shërbyer si rrugë ku një profit i konsideruar i PTK-së, transferohet në mënyrë permanente tek 'Z-Mobile'.

Historia e kësaj marrëdhënieje tregon se PTK-ja është dëmtuar edhe në raste tjera me kontratën me 'Z-Mobile'. Derisa PTK-ja ishte bërë gati për investime në teknologjinë e shërbimeve brezgjëra, të njohura si re 3G dhe 4G, një kompani (Infinite Solutions-KAD), e cila kishte lidhje të tërthorta me 'Devolli Company', pronare e 'Z-Mobile', kishte ushtruar ankesë tek Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), rreth procedurave të prokurimit.⁵¹ Kjo ankesë, krahas vendimit të

qeverisë për pezullim të investimeve, bëri që për gati një vit PTK-së, t'i bëhet i pamundur fillimi i investimit në teknologjinë brezgjëra, përderisa kishte kaluar po thuajse një vit që 'IPKO', kishte lancuar përdorimin e teknologjisë 3G. Arsyeja e ankesës së kompanisë mund të ketë qenë fakti që për përdorimi e brezit të ri frekuencorë 3/4G, 'Z-Mobile', do të duhej të arrinte marrëveshje të re me PTK-në, duke qenë se kontrata e tanishme parasheh vetëm përdorimin e frekuencave GSM. Në këtë aspekt, ankesa e bërë nga 'Infinite Solutions - KAD', mund të shihet se si mjet obstruksioni ndaj PTK-së, në mënyrë që 'Z-Mobile', të mund të arrinte një marrëveshje rreth përdorimit të brezit të ri frekuencorë 3/4G.

Duke qenë se kontrata në mes këtyre dy kompanive parashihte vetëm përdorimin e frekuencave GSM nga ana e Z-Mobile, dhe jo edhe përdorimin e teknologjisë 3G, për të cilën duhej një marrëveshje e re, kjo edhe mund të ketë qenë arsyeja e ankesës së kompanisë.

Po ashtu, për një kohë, numrat e 'Z-Mobile', ishin përdorur për t'i ikur terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, i njohur si fenomeni 'sim-to-sim'. Në shumë raste, drejtues të PTK-së, por edhe të IPKO-së, patën akuzuar 'Z-Mobile', numrat e së cilës ishin përdorur për t'i kryer këto terminime.⁵²

51 Gazeta JnK; Petrir Çollaku; "Ankesa Misterioze dhe mungesa e 3G-së së VALA-s"; 31.03.2014. <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,7926>
Ushtruesi i tashëm i detyrës së drejtorit ekzekutiv kishte deklaruar se konkurrenca i kishte penguar që të lancojnë teknologjinë 3G. Për më shumë shih: Koha Ditore; Visar Preberza; "Zyrtarë të 'Valës' thonë se konkurrenca i ka penguar në projektin 3G"; 26.11.2014. Shih po ashtu: Koha.net; "Gjykata e Tenderëve e hedh poshtë edhe ankesën e tretë për 3G të PTK-së"; Qershor, 2014. <http://koha.net/?id=27&l=14307>

52 Gazeta Express; 'Zona e Piratëve'; Arben Hyseni; Shkurt, 2010.
Gazeta JnK; "Haxha u Lutej Devollëve që ta Rrisnin Përqindjen"; Florent Spahija; Qershor, 2013. <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,5902>

Zyrat e PTK-së, ishin bastisur nga policia e EULEX-it, dhe rasti ishte dërguar në gjykatë, por në mungesë të provave, rasti rreth nënshkrimit të kontratës në mes PTK-së dhe 'Dardafone.net LLC', por edhe ai i transferimit të licencës janë mbyllur nga organet e drejtësisë.⁵³ Vlen të theksohet se pronarët kryesorë të 'Dardafone.net LLC', kishin angazhuar një firmë amerikane për t'i mbrojtur, e cila konsiderohet se ka ndikim shumë të fortë në elitën politike të vendit.⁵⁴

Së fundi, ARKEP-i ka nxjerrë një vendim⁵⁵ për dhënie në shfrytëzim të rezervave numerike⁵⁶ të 100 mijë numrave shtesë për operatorin virtual 'Z-Mobile'. Ky vendim ende nuk është aprovuar nga Bordi i ARKEP-it, por sipas raporteve të mediave prokuroria ka nisur hetimin rreth kësaj çështje.⁵⁷ Sipas kushteve të kontratës, në mes PTK-së dhe 'Dardafone.net LLC', parashihet që kjo e fundit t'i ketë në dispozicion vetëm 200 mijë numra. Gjykuar nga të dhënat e ARKEP-it shihet qartë se Z-mobile që nga viti 2012 ka arritur zenitin e përdorimit të 200 mijë numrave të ndarë sipas kontratës me PTK-në dhe 100 mijë numrat shtesë janë më se të domosdoshëm për ngritje të mëtutjeshme të kompanisë.

Një dozë të theksuar të kundërthënies rreth kësaj kontrate e ka luajtur edhe fakti se 'Devolli Corporation', pronare e 'Z-Mobile', është financuese e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK),⁵⁸ nën mandatin e së cilës edhe ishte nënshkruar kontrata. Për më shumë, në kohën kur kishin nisur bisedimet në mes PTK-së dhe 'Dardafone LLC', në krye të ndërmarrjes ishte një drejtor ekzekutiv i cili kishte garuar në zgjedhjet nacionale për PDK-në.⁵⁹ Kurse në kohën kur ishte aprovuar dhe nënshkruar kontrata finale me 'Dardafone.net LLC', në krye të Bordit të ndërmarrjes ishte një anëtar i PDK-së.⁶⁰ Përderisa drejtori ekzekutiv ishte konsideruar shumë i afërt me këtë strukturë politike.⁶¹ Për më shumë, gjatë gjithë procesit të nënshkrimit të kontratës në mes PTK-së dhe 'Dardafone.net LLC', në krye të ARKEP-it, institucioni i cili kishte lejuar dhe aprovuar bartjen e licencës së OVTM-së, nga 'Dardafone.LLC', tek 'Dardafone.net LLC', dhe i cili tash së fundmi ka marrë vendim për rezervimin e 100 mijë numrave shtesë për 'Z-mobile', ka qenë dhe vazhdon të jetë një ish i punësuar në 'Devolli Corporation', gjë që po ashtu është konsideruar si ndikim i drejtpërdrejt i kompanisë Devolli tek Rregullatori.⁶²

Në përgjithësi, kontrata me 'Z-Mobile', është konsideruar të ketë ndikuar jo vetëm në uljen e vlerës së PTK-së, por ka qenë edhe njëra ndër çështje më kundërthënëse gjatë procesit të privatizimit.

53 Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë; nr. 279/2012. http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/criminal-proceedings/BasiCourtPrishtina/279-2012/%282013.06.28%29%20JUD%20-%20%20B.D.%20et%20alia%20%28BC%20PR%29_%20ALB.pdf

Shih po ashtu: Gazeta Jeta në Kosovë; "Devollët dhe Drejtuesit e PTK-së Shpallen të Pafajshëm"; Florent Spahija; Qershor, 2013. <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,5912>

54 Squire Patton Boggs; "Patton Boggs Secures Acquittal in Rare White Collar Prosecution in Kosovo; Korrik 2013.

<http://www.pattonboggs.com/news/patton-boggs-secures-acquittal-in-rare-white-collar-prosecution-in-kosovo>

Për ndikimin e Patton Boggs në politikën vendore shih këtu:

Gazeta JnK; "Lobuesi Sekret" i Kosovës"; Petrit Çollaku; Nëntor, 2011. <http://gazetajnk.com/?cid=1%2C3%2C565>

Gazeta JnK; "Pagesa të Parregullta për Lobuesin Amerikan"; Parim Olluri dhe Petrit Çollaku; Qershor, 2013. <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,5759>

Gazeta JnK; "Njohjet Që Shtyeshin Nga Lobistët e Qeverisë Nuk u Realizuan"; Parim Olluri, mars 2013. <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,4864>

Gazeta JnK; Qeveria Pagoi për Takimet e Presidentes"; Parim Olluri; nëntor, 2012. <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,3685>

Gazeta JnK; "Lobistët e Thaçi Sjellin McDonaldsin në Kosovë"; Lawrence Marzouk; Korrik, 2012. <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,2783>

55 Vendimi i ARKEP Nr. 381 për 'Rezervimin e Serisë së Numeracionit Jo-Gjeografik - mobil (0)45 7xx xxx për përdorim të mëtutjeshëm nga Operatori Virtual - Dardafon.Net LLC'. <http://www.arkep-rks.org/repository/docs/Vendim%20Nr%20381.pdf>

56 Sipas legjislacionit në fuqi, rezervimi nënkupton lejimin e aplikuesit që t'i përdorë resurset më vonë pas nxjerrjes së vendimit për caktim/alokim.

57 Gazeta Express; "Prokuroria Speciale nis hetimet për 100 mijë numrat e "Z Mobile"; Janar, 2015. <http://www.gazetaexpress.com/lajme/prokuroria-speciale-nis-hetimet-per-100-mije-numrat-e-z-mobile-dokument-71418/>

58 "Devolli" sipas raporteve të Auditit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është i listuar si financues i PDK-së.

http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/Raporti_i_Auditimit_te_Fushates_2009_tngdhfues.pdf

Shih po ashtu: Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese - Prepor; "100 million"; Visar Duriqi dhe Qendrim Bunjaku; Prill, 2012. <http://www.prepor.com/sq/Pa-rate-dhe-politika/100-Milion-92>

59 Bisedimet rreth OVTM, kishin nisur kur në krye të PTK-së, ishte Adnan Merovci, i cili në zgjedhjet nacionale të viti 2007, kishte garuar për deputet në kuadër të listës së PDK-së.

60 Rexhë Gjonbalaj, kryetar i Bordit të PTK-së, ka qenë edhe është anëtarë i PDK-së, dega në Pejë, prej nga edhe vijnë pronarët e kompanisë 'Devolli'.

Gazeta JnK; 'Kryeshefi i PTK-së, kuadër i PDK-së', Parim Olluri, Shkurt, 2012. <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,1458>

61 Ish drejtori ekzekutiv i PTK-së, Shyqyri Haxha, është konsideruar shumë i afërt me PDK, dhe posaçërisht me kryeministrin e atëhershëm të Kosovës, Hashim Thaçi. Shih: Andrea Lorenzo Capussela; 'Eulex's Performance of its Executive Judicial Functions'; 9 February 2015.

http://media.wix.com/ugd/f81979_453475b7795a48f4a25d27b4e51d5942.pdf
Për më shumë, kryetari i tashëm i Bordit të ARKEP ka qenë i punësuar tek 'Devolli Company', pronare e 'Z-Mobile', përderisa gruaja e tij vazhdon të punojë në një kompani që është në pronësi të 'Devolli Company'. Shih: Gazeta Zëri: 'Devolli' ia punësoi gruan Ekrem Hoxhës; Besiana Xharra; Korrik, 2013.

62 Shih transkriptin seancës plenare të Kuvendit të Kosovës; Shtator 2009. http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2009_09_17_10_al.pdf

8. DY TENTIMET E DËSHTUARA PËR TA PRIVATIZUAR PTK-NË

Kosova është duke kaluar një transformim strukturor shumë të rëndë por të pandalshëm të sektorit të ekonomisë. Përderisa vendi është në përfundim të ciklit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), posa ka filluar privatizimin e Ndërmarrjeve Publike (NP). Edhe pse fillimi i procesit të privatizimit të NSH-ve, por tash edhe i NP-ve, është bërë nën kushte shtrënguese për shkak të obligimeve që rrjedhin nga procesi i transformimit strukturor të ekonomisë, duket se i vetmi qëllim i QeK, në rastin e procesit të privatizimit të PTK-së ka qenë që të gjenerojë të hyra të njëhershme nga shitja e asetit. Kësisoj, QeK ka dështuar që ta përcjellë këtë proces me politika të domosdoshme që do të stimulonin rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe të shtyjë përpara zhvillimin dhe modernizimin e sektorit të telekomunikacionit.

Si një vend në tranzicion dhe me institucione aspak të zhvilluara demokratike, Kosova është vend shumë i rrezikuar nga korrupsioni politik. Në këtë kuadër, privatizimi i NP-ve është parë si një mundësi për t'i dhënë fund përfshirjes së drejtpërdrejtë të politikës në fushën e ekonomisë,⁶³ dhe në këtë mënyrë për ta ndaluar korrupsionin politik.

Qeveria e Kosovës, në vazhdimësi ka përsëritur që arsyet kryesore për privatizimin e PTK-së kanë qenë performanca e dobët e ndërmarrjes, shtytja për inovacion teknologjik si dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve. Megjithatë, dhe bazuar nga mënyra se si QeK, ka menaxhuar dy proceset tashmë të dështuara të transformimit të pronës së PTK-së, objektivat e lartpërmendura jo vetëm se nuk janë arritur, por duket se ato nuk kanë qenë as pjesë e politikave praktike të privatizimit.

Që nga fillimi i procesit të transformimit të pronës së PTK-së, QeK nuk ka arritur të ofrojë shpjegime të domosdoshme rreth vendimit të saj për t'i privatizuar 75% të aksioneve të ndërmarrjes. Argumenti dhe shpjegimi kryesor në këtë drejtim që është ofruar nga qeveria ka arsyetuar shitjen e 75% të aksioneve të PTK-së, me faktin se ky vendim do

t'i tërheqë operatorët e mëdhenj të sektorit të telefonisë mobile në proces duke u ofruar kështu atyre të drejtën ekskluzive të vendim-marrjes.

Qeveria e Kosovës, në total ka paguar 4.2 milionë euro,⁶⁴ për këshilltarët e transaksionit dhe ata strategjik, roli i të cilëve ishte të përpilojnë pakon tenderuese për procesin e privatizimit të PTK-së, por që puna e të cilëve asnjëherë nuk është bërë e qasshme për publikun dhe si e tillë tashmë është pa asnjë vlerë. Këta këshilltarë kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në gjithë procesin veçmas gjatë fazës së parë të privatizimit, të cilët, ashtu siç do të dokumentohet në këtë raport, kanë ndikuar dhe determinuar procesin në mënyrë të njëanshme veprim që shtyri edhe në dështim të privatizimit të ndërmarrjes.

Në përgjithësi, dhe marrë parasysh gjithë procesin e privatizimit të PTK-së, mund të arrihet në disa përfundime: **a)** ka munguar një konsensus i gjerë i spektrit politik vendor rreth privatizimit të PTK-së, gjë që ka krijuar kontradikta dhe përplasje shumë të mëdha në mes faktorit politik dhe ka polarizuar skajshmërisht opinionin publik; **b)** ka pasur një ndërhyrje flagrante dhe jo të drejtë nga faktori ndërkombëtar në gjithë procesin e privatizimit; **c)** i gjithë procesi i privatizimit ka shpërfaqë qasje të njëanshme duke favorizuar kompani të caktuara si dhe duke cenuar ligjin dhe kriteret e tenderit dhe; **d)** QeK ka arritur, me gjithë kundërtëhëniet e shumta, t'i mbaj nën kontroll pakënaqësitë e sindikatës së PTK-së duke përfshirë në paketën tenderuese sigurimin e vendeve të punës për punëtorët e ndërmarrjes për një periudhë tri vjeçare në rast të privatizimit.

64 Qeveria e Kosovës ka tenderuar dy kontrata për dy proceset e privatizimit të PTK-së. 1) Më 2009, "Telco AG & Wolf Theiss", si këshilltar i transaksionit, fitoi kontratë me vlerë prej: 1.150.000,00 €; <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=24185>; përderisa "Huntton & Williams LLP", si këshilltar strategjik morri kontratë me vlerë 549,233.00 €; <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=24185>;

3) Më 2012, gjatë procesit të dytë të privatizimit të PTK-së, qeveria kishte angazhuar konzorciumin francezo-austriak "Lazard Freres S.S.S dhe Raiffeisen Investment AG", ku vlera e kontratës ishte: 2.495.000,00 €; https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=11&ved=0C-B4QFjAAoA&url=http%3A%2F%2Fkrpp.rks-gov.net%2FDownloadNotice.aspx%3FID%3D54402%26LID%3D1&ei=6GWQU4bNDfP34QSkIEY&us-g=AFQjCNH4CLUamfRdeokadaxg8bQuUOglw&sig2=B4JcDgJEvGZz_Q0smWuh-mA&bvm=bv.68445247,d.bGE&cad=rja

63 Në fakt, qëndrimi se përmes përjashtimit të përfshirjes së qeverisë (politikës) në ekonomi do të parandalohen korrupsioni, ka qenë argumenti kryesor i ish Ambasadorit amerikan, Christopher Dell. Për më shumë, shih: Komunikata e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë; Tetor, 2010. http://pristina.usembassy.gov/press_releases/2010-press-releases/privatisation_question.html

8.1. Tentimi i parë për ta privatizuar PTK-në: Tenderi që ekspozoi konfliktin e interesit

Për shkak të dështimit për të marrë aprovimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për shitjen e 75% të aksioneve të PTK-së,⁶⁵ më 2010, koalicioni qeverisës në mes PDK-së dhe LDK-së, do të përfundonte mandatin para kalimit të afatit të rregullt. Qeveria e pati të pamundur ta bind dhe ta marrë aprovimin e Kuvendit rreth privatizimit të PTK-së, përkundër faktit që ajo përdori argumentet kërcënuese siç ishin humbja e investitorëve potencial dhe anulimi i programit me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).⁶⁶ Megjithatë, rrethanat të cilat sollën dështimin e privatizimit të PTK-së, tregojnë pikë së pari për mungesën e një politike adekuate të privatizimit si dhe qasje të njëanshme të hisedarëve të ndryshëm të përfshirë në proces.

Janë tri zhvillime kryesore gjatë fazës së parë të privatizimit të PTK-së, që meritojnë vëmendje dhe analizë më të thellë duke qenë se ishin ato që në fakt çuan në dështim të privatizimit të ndërmarrjes. Zhvillimi i parë ka të bëjë me rastin e konfliktit të interesit që e ka përcjellë procesin e privatizimit të PTK-së, dhe që përfshinë këshilltarin e transaksionit. Zhvillimi i dytë ndërlidhet me arsyet reale që kanë shtyrë "Hrvatski Telekom d.d", të tërhiqet nga gara, veprim i cili edhe çoi në dështim të procesit të privatizimit. Zhvillimi i tretë përkon me ndërhyrjen e pazakontë dhe shumë problematike të ish ambasadorit amerikan, Christopher Dell, në gjithë rrjedhën e fazës së parë të privatizimit të PTK-së.

Më 2010, QeK e autorizoi Komisionin Qeveritar për Privatizimin e Postës dhe Telekomit (KQPPT), që të vazhdojë me procesin e privatizimit të PTK-së. Në Qershor 2011 KQPPT-ja, para-kualifikoi pesë ofertues⁶⁷ nga të cilët vetëm dy (Hrvatski Telekom d.d dhe Telekom Austria AG), u kualifikuan për të konkurruar për blerjen e 75% të aksioneve të PTK-së.⁶⁸

Në maj të vitit 2010, QeK mori edhe një vendim tjetër përmes të cilit i rekomandoi ARKEP-it që mos të lëshojë asnjë licencë tjetër për operator të telefonisë mobile për një periudhë pesë vjeçare duke e arsyetuar që "një vendim i tillë do të ulte ndjeshëm dhe në masë të madhe vlerën e PTK-së dhe do të ndikonte ndjeshëm në pjesëmarrjen e sektorit privat në PTK".⁶⁹

Për nevoja të këshillimit rreth procesit të privatizimit të PTK-së, KQPPT kishte angazhuar "Telco AG & Wolf Theiss".⁷⁰ Duhet theksuar se këshilltari i transaksionit 'Wolf Theiss', ishte përfaqësues i "Telekom Austria AG", përderisa kompania ishte në garë për licencën e dytë të telefonisë mobile më 2007. Në atë kohë, "Wolf Theiss", kishte dorëzuar disa akuza dhe ankesa në gjykata dhe institucione të Kosovës përkitazi me dyshimet për parregullsi dhe shkelje të procedurave gjatë tenderit të licencës së dytë të telefonisë mobile.⁷¹ Ky rast asnjëherë nuk është gjykuar nga gjykatat e Kosovës deri më tani. Sidoqoftë, përfshirja e "Wolf Theiss", si këshilltar i transaksionit në procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së, paraqet konflikt të pastër interesi duke qenë se kompania këshillonte qeverinë dhe ishte përgjegjëse për përpilimin e dokumentacionit dhe zgjedhjen e fituesit në një proces ku "Telekom Austria AG", ishte njëri ndër dy pretendentët kryesor së bashku me "Hrvatski Telekom d.d", për ta blerë PTK-në.

Në gusht të vitit 2011, KQP kishte kualifikuar dy ofertues nga pesë sa ishin para-kualifikuar për të vazhduar garën për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së, disa ditë më vonë lëshoi edhe një komunikatë duke siguruar se «procesi është duke u zhvilluar sipas strategjisë dhe planit në vijë me kërkesat ligjore dhe me transparencë të plotë». Hapi i ardhshëm i procesit, sipas KQP, ishte thirrja për propozime të ofertave teknike ku investitorëve të kualifikuar u lejohet qasje në tërë dokumentacionin relevant dhe u prezantohet draft marrëveshja për shitblerjen e aksioneve me kufizime potenciale, pas së cilës

65 Vendimi i Qeverisë së Kosovës përkitazi me privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_130-te_te_Qeverise_2010.pdf

66 Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet - Çohu, « Krimi dhe Korrupsioni në Kosovë: 10 Vite Bashkëjetesë me Politikën»; minuta 23-24; Qershor 2011. http://www.preportr.com/sq/Dokumentar/Korrupsioni-dhe-krimi-i-organizuar-n-Kosov-10-vjet-bashkjetes-me-politiken-55&video_id=26

67 Albtelekom Sh.A. Albania; Hrvatski Telekom d.d. Croatia-Mother Company Deutsche Telekom; Orascom Telecom Holding S.A.E., Egypt; SabaFon Yemen; Telekom Austria AG, Austria.

68 Shih vendimin e Komisioni Qeveritar i Privatizimit (KQP). <http://mzhe.rks-gov.net/?page=2,42,334>

69 Shih vendimin e Qeverisë së Kosovës për mos të lëshuar asnjë licencë në sektorin e telefonisë mobile për pesë vite. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_124-te_te_Qeverise_2010.pdf

70 Sipas një hulumtimi të "Pristina Insight", "Telco AG", në disa raste kishte përdorur numra ndërkombëtar premium (international premium rate numbers) jo sipas kërkesave ligjore. Për më shumë, burimet e "Pristina Insight" kishin pranuar që përzgjedhja e "Telco AG & Wolf Theiss", i kishte çuditur disa nga ofertuesit më serioz. Derisa QeK tashmë kishte përzgjedhur këshilltarin e transaksionit, ajo përzgjedhi edhe 'këshilltarin strategjik', një veprim që sipas burimeve të 'Pristina Insight', ishte i motivuar nga brengat në mes diplomatëve ndërkombëtar me statusin relativisht të panjohur të Telco.

71 Wolf Theiss; Profili i firmës; Referenca Kosova; Dhjetor, 2010. http://www.wolftheiss.com/tl_files/wolftheiss/RegionalDesks/Kosovo/WT_Kosovo%20Brochure%202011.pdf

kompanitë ftohen të japin ofertat e tyre financiare i cili është edhe kriteri i fundit për përcaktimin e tenderuesit fitues.⁷²

Dy muaj më vonë, në shtator, KQPPT lëshoi edhe një komunikatë përmes së cilës informoi që është shtyrë afati i fundit për dorëzimin e ofertave bazuar në kërkesat e dy kompanive pjesëmarrëse për një kohë prej dy javësh dhe në të njëjtën kohë u bëri thirrje “të gjitha kompanive që kanë shprehur interesin për privatizimin e PTK-së, për të marrë pjesë sërish në garë”.⁷³ Përkundër faktit që KQPPT e shtyri afatin e fundit për dorëzim të ofertave dhe u bëri thirrje kompanive që tashmë i kishte diskualifikuar të merren pjesë sërish në proces, në tetor e bëri të qartë që “asnjë kompani e re nuk është para-kualifikuar në afatin e ri dhe formalisht vetëm dy kompani mbesin të para-kualifikuara për privatizimin e PTK-së”.⁷⁴

Por çka e shtyri këtë veprim jo tipik të KQPPT-së, ku brenda dy muajve lëshoi dy komunikata kontradiktore rreth privatizimit të PTK-së? Pasi që procesi për privatizimin e aksioneve të PTK-së dështoi, pas tërheqjes së “Hrvatski Telekom d.d”, nga gara, kompania lëshoi një komunikatë duke justifikuar veprimin e saj për shkak të hetimeve që ishin duke u zhvilluar rreth akuzave për korrupsion kundër ish drejtorit të PTK-së dhe kryetarit të BD.⁷⁵ Mirëpo, Misioni Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX) kishte bastisur zyrat e PTK-së rreth dyshimeve për abuzime financiare dhe korrupsion në lidhje me kontratën me “Z-Mobile”, në korrik të vitit 2010,⁷⁶ pak më shumë se një muaj nga koha kur QeK kishte marrë vendim për privatizimin e PTK-së, dhe kur kishte kaluar pothuajse një vit qysh kur KQPPT kishte marrë vendim për t’i para-kualifikuar dy ofertues (*Hrvatski Telekom d.d, and Telekom Austria AG*). Në këtë kuadër dhe nga kjo perspektivë duket shumë e pazakonshme pse “Hrvatski Telekom d.d”, do të ankohej rreth dyshimeve për korrupsion dhe do të merrte vendim për tërheqje nga gara vetëm pak para vendimit përfundimtar për privatizimin e PTK-së përderisa tashmë kishte kaluar më shumë se një vit qysh

se hetimet penale kishin nisur kundër ish drejtorit ekzekutiv dhe kryetarit të BD të PTK-së.

Në fakt, procesi i privatizimit të PTK-së, hyri në ujëra të turbullta në momentin kur këshilltari i transaksionit (Telko AG & Wolf Theiss), publikoi raportin vlerësues për PTK-në. Sipas një hulumtimi të Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese (QKGH), “Hrvatski Telekom d.d”, u tërhoq nga gara për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së, duke qenë se e kishte konsideruar të gjithë procesin si të njëanshëm dhe të prirë përfundimisht kah favorizimi i “Telekom Austria AG”, veprim që çoi në dështim të tërësishëm të procesit të privatizimit.⁷⁷

Nga ky këndvështrim, mund të thuhet se vendimi i KQPPT për ta shtyrë afatin e fundit duke i bërë thirrje të sërishme kompanive të cilat nuk e kishin kaluar fazën e para-kualifikimit për dorëzim të ofertave financiare, mund të ketë qenë i bazuar në informatën se “Hrvatski Telekom d.d”, do të tërhiqet nga gara dhe e vetmja rrugë për ta parandaluar dështimin e procesit ishte ndërmarrja e këtij veprimi. KQPPT ndërmori këtë kurs për shkak se procedimi me vetëm një ofertues (Telekom Austria AG), do të përbënte shkelje flagrante të procedurave ligjore të prokurimit publik si dhe të kriterëve të tenderit.

Pa marrë parasysh motivet e vërteta të tërheqjes së “Hrvatski Telekom d.d”, nga gara e privatizimit, veprimi i saj bëri që i gjithë procesi të dështojë. Ndërkohë PTK-ja mbeti e bllokuar edhe për më shumë se dy vite në investime kapitale dhe zhvillim të mëtejshëm të teknologjisë brez-gjerë dhe kështu e paaftë për t’i bërë ballë konkurrencës së saj.

Sidoqoftë, narracioni i përgjithshëm i fazës së parë të tentimit privatizimit të PTK-së nuk është i plotë pa përfshirjen në të edhe ndërhyrjen e ish-ambasadorit amerikan, Christopher Dell. Ish ambasadori amerikan, publikisht kishte dalë në përkrahje të privatizimit sa më të shpejtë të resurseve publike duke e arsyetuar këtë veprim me parandalimin e përfshirjes së politikës në çështjet ekonomike. Sipas tij, kjo ishte mënyra më efektive për ta ndaluar korrupsionin politik sepse kështu i pamundësohet politikës qasje në resurset ekonomike.⁷⁸ Mirëpo, ndërhyrja e tij ishte edhe më e drejtpërdrejtë. Në shtator të vitit 2010, derisa Parlamenti i Republikës së Kosovës përpiqej ta aprovonte Strategjinë e Përfshirjes së Sektorit Privat në

72 Komisioni Qeveritar i Privatizimit, Komunikatë për shtyp. 20.05.2011. <http://mzhe.rks-gov.net/?page=1,42,353>

73 Komisioni Qeveritar i Privatizimit, Komunikatë për shtyp. 02.09.2011. <http://mzhe.rks-gov.net/?page=1,42,370>

74 Komisioni Qeveritar i Privatizimit, Komunikatë për shtyp. 10.10.2011. <http://mzhe.rks-gov.net/?page=1,42,388>

75 Evropa e Lire; Nadie Ahmeti; “Telekomi kroat tërhiqet nga privatizimi i PTK-së?”; 11.10.2011. <http://www.evropaelire.org/content/article/24356041.html>
Gazeta JnK; “Kroatët Tërhiqen nga PTK-ja?”; 11.10.2011. <http://gazetajnk.com/index.php?cid=1,1018,278>
Kosova Press; “Haxha: Po luhet lojë me PTK-në”; 11.10.2011. <http://www.kosova-press.com/archive/?cid=1,3,136750>

76 European Union Rule of Law Mission - EULEX Komunikatë për shtyp; 15.07.2010. <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0078.php>

77 Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese - Preportr; “Tenderi që ekspozoi kapjen e qeverisë”; 23.11.2011. <http://www.preportr.com/en-us/Public-assets-and-privatization/The-tender-which-exposed-the-capture-of-the-government-52>

78 Në fakt, qëndrimi se përmes përjashtimit të përfshirjes së Qeverisë (Politikës) në ekonomi do të parandalohen korrupsioni, ka qenë argumenti kryesor i ish Ambasadorit amerikan, Christopher Dell. Për më shumë, shih: Komunikata e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë; Tetor, 2010. http://pristina.usembassy.gov/press_releases/2010-press-releases/privatisation_question.html

PTK, kryetari i Parlamentit e vendosi Strategjinë në votim pas ndërhyrjes së ish ambasadorit amerikan përkundër mungesës së qartë të kuorumit në seancë.⁷⁹ Megjithatë, ish kryetari i Parlamentit nuk e nënshkroi Strategjinë dhe procesi në tërësi dështoi, gjë që çoi edhe në rënien e koalicionit qeveritar në mes PDK-së dhe LDK-së.⁸⁰

8.2. Tentimi i dytë për ta privatizuar PTK-në

Me shpërbërjen e qeverisë si pasojë e mos arritjes së një konsensusi në mes partnerëve qeverisës (PDK-LDK) për privatizimin e PTK-së, vendi po shkonte drejt një faze shumë të vështirë, të aprovimit sa më të shpejtë të buxhetit për vitin 2011. Derisa PDK-ja kishte marrë shumicën e votave në zgjedhjet e vitit 2010, ajo ishte shumë e vetëdijshme që mundësia për ta marrë aprovimin e Parlamentit për ta shitur PTK-në ishte pothuajse e pamundur. Marrë në konsideratë këtë fakt, koalicioni i ri qeverisës PDK-AKR (Aleanca për Kosovën e Re), ndërmori një hap shumë të paprecedent duke përfshirë të drejtën e privatizimit të PTK-së në kuadër të nenit 4 të Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011⁸¹ përmes të cilit veprim edhe arriti aprovimin e Parlamentit për t'i tenderuar 75% të aksioneve të ndërmarrjes.

Ky hap i koalicionit qeverisës është parë si kërcënues për shkak se QeK me vendimin e saj për ta përfshirë privatizimin e PTK-së, në kuadër të Ligjit për Buxhet për vitin 2011 i vendosi deputetët para një akti të kryer. Duke mos aprovuar Ligjin për Buxhet të vitit 2011, deputetët rrezikonin ta lënë vendin pa buxhet dhe kështu t'i pamundësonin qeverisë ofrimin e shërbimeve, veprim që bëri të votohej Ligji i cili parashihte privatizimin e PTK-së. Qeveria e pa si rrugëdalje ndërmarrjen e këtij veprimi për shkak se në një anë, sipas

Ligjit për Ndërmarrje Publike, shitja e aksioneve të ndonjë NP-je nuk mund të ndodhë pa një vendim të Kuvendit,⁸² dhe në anën tjetër, ajo ishte shumë e vetëdijshme se procedimi i një ligji të veçantë për privatizimin e PTK-së, do të haste në kundërshti dhe pengesa shumë të mëdha nga ana e vet deputetëve të koalicionit qeverisës. Menjëherë pasi QeK, kaloi Ligjin për Buxhetin më 2011, ajo mori vendimin e dytë për t'i privatizuar 75% të aksioneve të PTK-së.⁸³

Edhe pse Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk kishte aprovuar shitjen e PTK-së në shtator të vitit 2010, ky fakt nuk e kishte penguar qeverinë që të përfshinte në buxhetin e vitit vijues (2011), një shumë prej 300 milionë eurosh të cilën e konsideronte se do të vinte nga privatizimi i PTK-së.⁸⁴ Qeveria do të përdorte këtë strategji - përfshirjen e 300 milionë eurove në buxhetin e shtetit për tri vite me radhë (2011-2013) - deri sa edhe tentimi i dytë për ta privatizuar PTK-në dështoi. Ky veprim i qeverisë është kritikuar për shkak të vendosjes së një pragu të çmimit që ajo e priste nga blerësi i ardhshëm, edhe përkundër që qeveria në vazhdimësi ka mbrojtur qëndrimin se është tregu ai i cili e përcakton vlerën e PTK-së. Kritika në fakt doli e vërtetë sepse konsorciumi fitues "ACP Axos Capital Partners and Najafi Companies", ofroi 277 milionë euro për PTK-në.

Procesi i dytë i privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së, është përcjellë me më shumë parregullsi krahasuar me procesin e parë përfshirë këtu edhe thyerje të ligjit dhe kriterëve të para-kualifikimit. Në përgjithësi, janë tri shkelje të ndryshme që e kanë përcjellë procesin dhe që meritojnë vëmendje.

E para, QeK, por edhe KQPPT, kanë dështuar që të ofrojnë argumente bindëse kundër pretendimeve se procesi i privatizimit gjatë fazës së dytë ka vazhduar pa një vendim të qartë të Kuvendit dhe kështu është konsideruar si jo-ligjor. Ashtu siç është përmendur edhe më lartë, sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike, QeK nuk mund të vazhdojë me procesin e shitjes së aksioneve të NP, po që se një vendim i tillë nuk

79 Në muajin Shtator 2010, kur Parlamenti po diskutonte privatizimin e PTK-së, konkretisht aprovimin e Strategjisë për Përfshirjen e Sektorit Privat në PTK, në seancë kishte vetëm 50 deputetë, përderisa sipas Rregullores së Kuvendit, duhet të paktën 51 deputetë, që të plotësohet kuorumi i domosdoshëm për të marrë vendime të plotfuqishme.

80 Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet - Çohu, « Krimi dhe Korrupsioni në Kosovë: 10 Vite Bashkëjetesë me Politikën»; minuta 23-24; Qershor 2011. http://www.preportr.com/sq/Dokumentar/Korrupsioni-dhe-krimi-i-orga-nizuar-n-Kosov-10-vjet-bashkjetes-me-politiken-55&video_id=26

81 Ministria e Financave; Ligji i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011; Neni 4 Vendimi për Privatizim me Ndikim Fiskal Vendimi i Qeverisë nr.02/03 i dt. 9 mars 2011, për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës, Sh.A., i cili i është bashkangjitur këtij Ligji si Aneks, konsiderohet i miratuar nga Kuvendi nga data e hyrjes së fuqi të këtij ligji. Ky miratim e plotëson kërkesën për miratim nga Kuvendi të përcaktuar me nenin 9.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. <https://mf.rks-gov.net/en-us/Budget/Budget-of-Republic-of-Kosovo/Central-Budget>

82 Ligji mbi ndërmarrjet Publike - 03/L-087; Shitja e Aksioneve 9.1 Aksionet në një NP Qendrore mund të shiten lirisht nëse Qeveria miraton një vendim me shkrim me të cilin autorizohet një Komision Qeveritar për Privatizim për të vazhduar me tenderimin dhe shitjen e aksioneve, me kusht që ky vendim të miratohet me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Kosovës. Pas miratimit të këtij vendimi nga Qeveria dhe Kuvendi, Komisioni Qeveritar për Privatizim është i autorizuar të kryejë një tender dhe t'i shesë aksionet në fjalë. <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

83 vendimi i Qeverisë së Kosovës rreth privatizimit të PTK-së. http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_trete_te_Qeverise_2011.pdf

84 Shih Buxhetin për vitin 2011. <https://mf.rks-gov.net/en-us/Budget/Budget-of-Republic-of-Kosovo/Central-Budget>

aprovohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit.⁸⁵ Përderisa QeK në këtë aspekt referonte vendimin e Kuvendit kur privatizimi i PTK-së ishte futur në kuadër të nenit 4 të Ligjit për Buxhet të vitit 2011,⁸⁶ ajo dështoi që të ofrojë argumente bindëse që baza e njëjtë ligjore mund të aplikohet edhe në vitet 2012-13. Mungesa e bazës ligjore për të vazhduar me privatizimin e PTK-së, në vitet 2012-13, ishte evidente duke qenë se Ligji për Buxhet, është i kufizuar në kuadër të një viti fiskal dhe efektet e tij janë të pavlefshme në vitet në vazhdim. Në këtë kontekst, përderisa QeK nuk kishte inkorporuar privatizimin e PTK-së në Ligjet e Buxhetit në vitet 2012,⁸⁷ dhe 2013,⁸⁸ dhe marrë parasysh që nuk kishte një vendim nga ana e Kuvendit, ishte më se e qartë se baza ligjore për privatizimin e PTK-së ka munguar.

E dyta, KQPPT shkeli kriteret e para-kualifikimit kur zgjodhi “ACP Axos Capital GmbH and Najafi Companies”, si fituese për privatizimin e PTK-së. Sipas regjistratit të biznesit por edhe të dhënave financiare të “ACP Axos Capital GmbH”, është e qartë që kompania nuk ka përmblusur pothuajse asnjë nga kërkesat e para-kualifikimit.⁸⁹ Njëra nga shkeljet më evidente ishte neni 4.1.2 i cili kërkonte që “Ofertuesi (apo në rastin e një konsorciumi, anëtar kryesor i tij), duhet të demonstrojë që: (a) ka asete nën menaxhim me vlerë prej të paktën 750 milionë dollarë në vitin 2012, apo (b) ka ngritur fonde në total prej të paktën 200 milionë dollarë gjatë shtatë viteve të fundit. Sipas raporteve financiare të “ACP Axos Capital GmbH”, shihet se kompania është regjistruar me një kapital fillestar prej 25 mijë euro dhe që më 2011 ka pasur fitim neto prej vetëm 2500 euro.⁹⁰ Për më shumë, KQPPT nuk ka ofruar informacionin e domosdoshëm në lidhje me kërkesat tjera të fazës

së para-kualifikimit që binin nën nenin 4.1.2 (c).⁹¹

Aspekti i tretë i përket legalitetit të vendimit të KQPPT. Në gusht të vitit 2012, KQPPT aprovoi listën finale të pesë kompanive dhe konsorciumeve,⁹² të ndryshme që kishin kaluar fazën e para-kualifikimit dhe që ishin ftuar të merinin pjesë në tenderin për blerjen e 75% të aksioneve të PTK-së.⁹³ Megjithatë, shtatë muaj më vonë dhe pasi që ishte shtyrë afati i dorëzimit të ofertave, KQPPT aprovoi ndryshimet në konsorciumin “Columbia Capital and ACP Axos Capital GmbH”, duke i lejuar kësaj të fundit të drejtën të jetë lider i konsorciumit, tash me fondin investues “Najafi Companies”.⁹⁴ “Axos-i”, kishte qenë pjesë e fazës së parë të privatizimit të PTK-së, por nuk kishte kaluar fazën e para-kualifikimit.

Përkundër parregullsive të lartpërmendura, tri ambasada kishin lëshuar një komunikatë e cila mbështeste pri-

85 Ligji mbi ndërmarrjet Publike - 03/L-087; Shitja e Aksioneve 9.1 Aksionet në një NP Qendrore mund të shiten lirish nëse Qeveria miraton një vendim me shkrim me të cilin autorizohet një Komision Qeveritar për Privatizim për të vazhduar me tenderimin dhe shitjen e aksioneve, me kusht që ky vendim të miratohet me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Kosovës. Pas miratimit të këtij vendimi nga Qeveria dhe Kuvendi, Komisioni Qeveritar për Privatizim është i autorizuar të kryejë një tender dhe t'i shesë aksionet në fjalë.
<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2547>

86 Ministria e Financave; Ligji i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011; Neni 4 Vendimi për Privatizim me Ndikim Fiskal Vendimi i Qeverisë nr.02/03 i dt. 9 mars 2011, për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës, Sh.A., i cili i është bashkangjitur këtij Ligji si Aneks, konsiderohet i miratuar nga Kuvendi nga data e hyrjes së fuqi të këtij ligji. Ky miratim e plotëson kërkesën për miratim nga Kuvendi të përcaktuar me nenin 9.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.
<https://mf.rks-gov.net/en-us/Budget/Budget-of-Republic-of-Kosovo/Central-Budget>

87 Ministria e Financave; Ligji i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012.
<http://mf.rks-gov.net/en-us/Budget/Budget-of-Republic-of-Kosovo/Central-Budget>

88 Ligji i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2013. <http://mf.rks-gov.net/en-us/Budget/Budget-of-Republic-of-Kosovo/Central-Budget>

89 Ministria e Zhvillimit Ekonomik; kriteret e para-kualifikimit përkitazi me privatizimin e PTK-së. http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/IPQ_22-06-12_technical_and_financial_criteria_Eng.pdf

90 Organizata Çohu ka pasur qasje në regjistrat e biznesit përfshi edhe raportet financiare të “ACP Axos Capital GmbH”, për vitin 2011.

91 Privatizimi i Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A. (PTK) – Instruksionet e Para-kualifikimit; 4.1.2. (c) plotëson njërin apo më shumë kriteret të listuara nga i. – iv. i. ka investuar në 10 vitet e fundit apo është tash investitor në minimum prej 20% të aksioneve (equity shareholding of 20%), në të paktën një operator telekomik me të ardhura vjetore që lidhen me shërbimet e telekomit dhe që tejkalon shumën prej 300 milionë euro në të paktën një vit të periudhës investuese, apo, ii. ka pranuar një letër të interesit për t'u përfshi në një marrëveshje konsorciumi në lidhje me pjesëmarrjen në kapital (equity participation) (me të paktën 10% të zotërimit të kapitalit) me një operator telekomik më 2011 me të ardhura që lidhen me shërbimet e telekomit që nuk tejkalojnë 300 milionë euro, apo iii. ka pranuar letër të interesit për t'u përfshi në një bashkëpunim me një operator telekomik më 2011 të ardhurat që lidhen me shërbimet e telekomit nuk tejkalojnë 500 milionë euro, apo iv. ose (i) ka një aksionar që ka menaxhuar një investim (me më shumë se 20% të pronësisë) në 10 vitet e fundit në të paktën një operator telekomik me të hyra të lidhen me shërbimet e telekomit që tejkalojnë 500 milionë euro gjatë 1 viti apo (ii) ka momentalisht punëson profesionistë (me të paktën 20% pronësi) në 10 vitet e fundit në të paktën një operator telekomik me të ardhura nga shërbimet e telekomit që tejkalojnë 500 milionë euro gjatë vitit të fundit.
Për sa i përket iii. lartë, kur të dorëzohet oferta gjatë fazës së dytë të këtij tenderi, Aplikantit do t'i kërkohej të shënoj shërbimet kyçe të ofruara nga operatori i telekomit si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit, përfshi njërin apo më shumë nga artikujt e mëposhtëm (a) deri në (d):

(a) operatori telekomit ofron markën e tij tek PTK për një periudhë më pak se 5 vjeçare;
(b) operatori i telekomit ka të drejtën dhe do të ushtroj të drejtën që të caktoj një anëtar të bordit nga kompania e tij tek bordi i PTK për një periudhë prej jo më pak se 5 vjet;
(c) operatori i telekomit do të nënshkruaj marrëveshje operimi, mirëmbajtjeje dhe me PTK-në; dhe/apo
(d) operatori i telekomit do të themeloj një komision këshillimor tek PTK-ja, i cili përbëhet nga të paktën 3 nëpunës nga operatori i telekomit për një periudhë prej të paktën 5 viteve.
http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/IPQ_22-06-12_technical_and_financial_criteria_Eng.pdf

92 1) Albright Capital Management LLC, në bashkëpunim me Portugal Telecom; 2) Columbia Capital, në konsorcium me ACP Axos Capital GmbH, dhe në bashkëpunim me British Telecom - Poland (e poseduar nga British Telecom); 3) M1 International Limited; 4) Turkcell; 5) Twelve HORNBEAMS, në konsorcium me Avicenna Capital LLC, dhe në kooperim me Sofrecom (pjesë e Telekomit Francez)

93 Komisioni Qeveritar i Privatizimit, Komunikatë për shtyp. 17.08.2012. <http://mzhe.rks-gov.net/?page=2,42,531>

94 Komisioni Qeveritar i Privatizimit, Komunikatë për shtyp. 05.03.2013. <http://mzhe.rks-gov.net/?page=2,42,625>

vatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së.⁹⁵ I gjithë faktori ndërkombëtar insistonte në përfundim sa më të shpejt të transaksionit të PTK-së dhe asnjëherë nuk kishte vënë në pikëpyetje dyshimet që ishin ngritur në opinion rreth legalitetit të procesit.

Përgjatë gjithë fazës së dytë të procesit tenderues media lokale ka raportuar për aktivitete lobuese shumë të forta të ndërmarrja nga aktetë të ndryshëm të përfshirë në privatizimin e PTK-së. Njëri nga ofertuesit në proces ishte edhe "Albright Capital Management LLC", e cila kompani drejtohet nga ish sekretarja e shtetit të SHBA-së, Madeleine Albright. Përfshirja e ish sekretares së shtetit në garën për t'i privatizuar aksionet e PTK-së jo vetëm se ishte parë si mundësi për vendim të njëanshëm të institucioneve lokale, por ishte edhe një rast i pastër i konfliktit të interesit duke qenë se Madeleine Albright, është aksionare në IPKO,⁹⁶ operatori mobil rival kryesor i PTK-së. Më vonë, gjatë procesit, "Albright Capital Management LLC", tërhiqet nga gara.⁹⁷ Për më shumë, media po ashtu kishte raportuar se James Pardew, ish sekretari i shtetit të SHBA për Demokraci në Ballkan gjatë administratës së Klintonit, kishte lobuar tek qeveria për njërën nga kompanitë konkurruese "Avicenna Capital LLC".⁹⁸

Në fund, konzorciumi "ACP Axos Capital Gmbh and Najafi Companies", në konkurrencë me "M1 International Limited", mbetën dy kompanitë finale për privatizimin e PTK-së.⁹⁹ Pasi që ofertat ishin dorëzuar, "ACP Axos Capital Gmbh and Najafi Companies", kishte ofertuar me 277 milionë euro, përderisa "M1 International Limited", me 155 milionë euro për blerjen e 75% të aksioneve të PTK-së.¹⁰⁰ Marrë parasysh ofertat, QeK mori vendim për aprovimin e raportit për shitjen e aksioneve të PTK-së tek "ACP Axos Capital Gmbh and Najafi Companies".¹⁰¹

95 Shih Komunikatën e përbashkët të Ambasadave rreth privatizimit të PTK-së. PTK; 16.04.2013. http://pristina.usembassy.gov/2013_press_release12.html

96 Shih aksionarët e "IPKO Telecommunications" LLC, në regjistrin e biznesit të ARBK-së. http://www.arbk.org/sq/Rezultatet-e-Bizneseve/70064420?n=b=0&eb=IPKO&la=0&lp=0&main_activity=0&other_activity=0&page_b=0

97 Gazeta JnK; Parim Olluri; "Firma "Albright..." Konfirmon Tërheqjen"; 27.12.2012. <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,4238>

98 Gazeta JnK; "Secili konkurrent për PTK-në me probleme"; Parim Olluri; Tetor, 2012. <http://gazetajnk.com/index.php?cid=1,987,3560>

99 Komisioni Qeveritar i Privatizimit, Komunikatë për shtyp. 03.04.2013. <http://mzhe.rks-gov.net/?page=2,42,651>

100 Komisioni Qeveritar i Privatizimit, Komunikatë për shtyp. 12.04.2013. <http://mzhe.rks-gov.net/?page=1,42,657>

101 Vendimi i Qeverisë së Kosovës rreth aprovimit të raportit të KQP mbi privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimi_i_mbledhjes_se_125-te_te_Qeverise_2013.pdf

Por, pa marrë parasysh që "M1 International Limited", ishte përzgjedhur për të vazhduar me procesin e blerjes së aksioneve të PTK-së, duhet theksuar se kompania tashmë ishte stigmatizuar në mediat lokale si e dyshuar me lidhje me organizatën terroriste "Hezbollah". Në këtë kontekst, "M1 International Limited", pothuajse nuk kishte asnjë mundësi të privatizonte PTK-në.¹⁰²

Që nga momenti i vendimit të QeK, kur aprovoi raportin e KQPPT rreth përmbylljes së transaksionit me "ACP Axos Capital Gmbh and Najafi Companies", u duk se çdo gjë ishte në vend për sa i përket privatizimit të PTK-së. Por, procesi hynë në rrugë të panjohura menjëherë pasi që KQPPT bëri të ditur fituesin e procesit. Derisa disa dokumente kishin rrjedhur në media duke ekspozuar profilin e ultë të "Axos", në sektorin e telekomunikacionit si dhe financave të fondit,¹⁰³ origjina e kapitalit për blerjen e PTK-së, ishte ndër çështjet më kundërthënëse. Shqetësimi rreth origjinës së kapitalit u bë edhe më kontrovers pasi që një raport hulumtues tregoi se kapitali i "Axos" vjen nga një fond i cili është i regjistruar në Cayman Island,¹⁰⁴ njëra nga parajsat e shumta fiskale në botë. Po ashtu, kishte raporte të mediave se "Axos", po haste në vështirësi të shumta për të siguruar fonde nga institucionet financiare ndërkombëtare për t'i blerë aksionet e PTK-së.¹⁰⁵

Sidoqoftë, më 31 dhjetor 2013, gati tetë muaj pasi QeK, kishte aprovuar raportin për shitjen e 75% të aksioneve të PTK-së kur edhe iu dha e drejta konzorciumit "ACP Axos Capital Gmbh and Najafi Companies", për të vazhduar me pagesën, KQPPT vendosi ta anuloi nënshkrimin e kontratës. Arsyeja ishte mungesa e kuorumit në sesionin plenar të Kuvendit për të vendosur për privatizimin e PTK-së, por edhe duke qenë se data 30 dhjetor 2013, ishte data e fundit kur duhet të nënshkruhet kontrata,¹⁰⁶ një sinjal i qartë që vendimi i Kuvendit për privatizimin e PTK-së, kishte munguar që nga nisja e procesit të dytë të privatizimit.

102 Përderisa procesi i tenderimit ishte duke u zhvilluar, gazeta "Zëri" raportoi që "M1 International Limited" është pjesë e "M1 Group", një korporatë në pronësi të ish kryeministrit të Libanit, Najib Mikati, dhe të vëllait të tij, Taha Mikati. Ish kryeministri i Najib Mikati, ishte mbështetur nga organizata terroriste Hezbollah. <http://www.bbc.com/news/world-middle-east-12273178>

Shih po ashtu: Gazeta JnK; Parim Olluri; "Secili Konkurrent për PTK-në me Probleme"; 22.10.2012. <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,3560>

103 Këto dokumente ishin publikuar nga Lëvizja Vetëvendosje!

104 Gazeta JnK; Parim Olluri and Nate Tabak; "Paratë e Blerjes Vijnë nga Ishujt Cayman"; 29.04.2013. <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,5454>

105 Gazeta JnK; Petrit Çollaku; "Bankat e Fuqishme Nuk Tregojnë a Mbështesin Axos-in"; 24.06.2013. <http://gazetajnk.com/?cid=1,987,5865>

106 Komisioni Qeveritar i Privatizimit, Komunikatë për shtyp. 31.12.2013. <http://mzhe.rks-gov.net/?page=2,42,775>

9. ZHVILLIMET E FUNDIT NË PTK

Të dhënat e fundit të ARKEP-it tregojnë se penetrimi i telefonisë mobile pothuajse ka arritur limitet e tij dhe ky fakt e bënë të pashmangshëm transformimin e PTK-së, nga një operator i fokusuar ekskluzivisht në ofrim të shërbimeve të telefonisë së zërit, në një operator modern të shkëmbimit të të dhënave me shpejtësi shumë të shpejtë. Kjo posaçërisht në kontekstin e një popullate shumë të re ku grup moshë nga 15 deri në 65 vjeç përbën 65.3% të popullsisë së vendit.¹⁰⁷

Marrë parasysh tkurrjen e vazhdueshme, PTK-ja tashmë ka filluar një fazë të ristrukturimit të brendshëm të saj. Bordi i PTK-së, në tetor të vitit të kaluar mori një vendim për shkarkim të drejtorit ekzekutiv. Sipas komunikatës për shtyp, vendimi i BD, është marrë bazuar në rekomandimet e Komisionit të Auditimit, dhe bazuar në nenin 18.3 të Ligjit për Ndërmarrje Publike, i cili shprehimisht përcakton se: "nëse NP dështon në arritjen e caceve të saj të performancës

për dy vite financiare radhazi, Bordi i Drejtorëve, është i detyruar të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e KE-së".¹⁰⁸ Në fakt, ky është i pari vendim i kësaj natyre në historinë e ndërmarrjes, një kulturë kjo e mosndëshkueshmërisë e cila ka rezultuar si pasojë e mos funksionimit të mekanizmave të llogaridhënies për shkak të praktikave shumë të shprehura të emërimeve politike.

Në këtë kontekst, pra të fillimit të reformave strukturore në PTK, duhet të shihet edhe vendimi i fundit i ndërmarrjes rreth nivelizimit të pagave – sipas deklarimeve të fundit të kryeshefit të ri ekzekutiv ky proces tash për tash nuk do të fillojë të zbatohet¹⁰⁹ – i cili bazohet në një rekomandim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), bërë në vitin 2012. Sipas këtij rekomandimi, PTK-ja nuk duhet të kalojë nivelin e shpenzimeve operative më shumë se 20%, në raport me


¹⁰⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës; Atlasi i Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë; 2011. <https://ask.rks-gov.net/ser/images/files/Atlas%20popisa%20stanovnistva%20Kosovo.pdf>

¹⁰⁸ Shih nenin 18.3 të Ligjit për Ndërmarrje Publike. <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2547>

¹⁰⁹ Intervistë me drejtorin ekzekutiv të PTK-së, Agron Mustafa, realizuar më 07.04.2015.

FIG. 19 PENETRIMI I TELEFONISË MOBILE T1 2010 - T3 2014

 Penetrimi



Burimi: Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP

të hyrat e përgjithshme. Sidoqoftë, në vitin 2012, dhe bazuar në këtë rekomandim, PTK-ja kishte bërë uljen e pagave të punëtorëve, por pas ankesave të rreth 900 punonjësve të kësaj ndërmarrje, të gjitha instancat e gjykatave kishin vendosur në favor të tyre dhe kompania ishte detyruar t'ua kthente mjetet e ndalura.

Rinisja e planit të investimeve dhe lëshimi në përdorim i shërbimeve brez-gjëra 3G, por edhe futja në funksion e shërbimeve 4G në maj të 2015, janë fillimi i projekteve të investimeve kapitale, projekte këto të cilat synojnë jo vetëm ta parandalojnë tkurrjen e mëtutjeshme të të hyrave dhe rënien e përqindjes së tregut, por do të ndihmojnë edhe në transformimin strukturor të PTK-së dhe kthimin e ndërmarrjes në binarë të zhvillimit të qëndrueshëm.

Bazuar në planin e rishikuar të biznesit të PTK-së, për vitin 2015-2019,¹¹⁰ shtyllë kryesore e qëndrueshmërisë së PTK-së vlerësohet të jetë transformimi nga një operator me fokus në ofrimin e shërbimeve të telefonisë së zërit në ndërmarrje që ofron shërbime të shkëmbimit të të dhënave me një shpejtësi shumë të lartë. Për më shumë, sipas këtij plani synohet që trendi në rënie i të hyrave të fillojë të stabilizohet gjatë vitit 2015 dhe të ketë një rritje graduale prej 3-5% gjatë viteve 2016/17 për sa i përket operatorit mobil Vala, dhe deri në 9-10 % për sa i përket PTK-së në përgjithësi. Në kuadër të tij parashihet po ashtu që gjatë periudhës kohore 2015-2019, të fillohet me ofrimin e produkteve konvergjente në nivel të ndërmarrjes duke kombinuar kështu shërbimet e telefonisë mobile, internetit, IPTV dhe telefonisë fikse.

Duhet theksuar se ky parashikim i PTK-së është shumë ambicioz dhe si i tillë duhet marrë me rezervë posaçërisht për dy arsye. E para, Qeveria e Kosovës ka parashikuar që gjatë viteve 2015-2017, të marrë dividendë nga PTK-ja në shumën prej 30 milionë eurosh për çdo vit.¹¹¹ Ky vendim i QeK, bie në kundërshtim të plotë me Planin e Biznesit të PTK-së (2015-2019), konkretisht rrezikon seriozisht projektet e parashikuara kapitale si dhe është në mospërputhshmëri me projeksonet e rrjedhjes së parasë.¹¹² Vendimi në fakt dëshmon për mos bashkëveprim të plotë në mes aksionarit (qeverisë) dhe Bordit e menaxhmentit të PTK-së në strukturimin dhe zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të ndërmarrjes. E

dyta, sipas vlerësimeve të fundit nga menaxhmenti i PTK-së, plani i biznesit 2015-2019, duhet rishikuar prapë dhe parashikimet për rritje të përqindjes së të hyrave të ndërmarrjes për vitet në vijim duhet zvogëluar. Kjo duke qenë se gjatë vitit 2015, pritet tkurrje e mëtutjeshme e të hyrave të ndërmarrjes¹¹³ gjë që tregon se në thelb, Planin e Biznesit nuk është përpiluar bazuar në parametra të studiuar mirë dhe të arritshëm.

Pavarësisht nga kjo që u tha më lartë, emërimi i fundit i drejtorit ekzekutiv të PTK-së, anëtar i PDK-së dhe i konsideruar si i afërt me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, një ish drejtues i Shërbimit Informativ të Kosovës (SHIK),¹¹⁴ ofron sinjal të kundërt dhe shpërfaqë tendencat se ndërhyrja e drejtpërdrejtë e politikës në menaxhimin e ndërmarrjes nuk do të stopohet, por praktikatat e deritashme të politizimit të skajshëm të ndërmarrjes duket se do të vazhdojnë. Reagimi i kryeministrit rreth emërimit të drejtorit të ri të PTK-së, duke e konsideruar atë si 'riciklim të njerëzve të njëjtë', dhe duke konstatuar se ky vendim sjellë në pikëpyetje besueshmërinë e Bordit dhe të objektivat të tij,¹¹⁵ tregon se marrëdhënia në mes aksionarit dhe menaxhmentit mund të përshkruhet me 'armiçësi' gjë që mund ta bëjë shumë të vështirë në mos të pamundur procesin e këndelljes së ndërmarrjes dhe vendosjen e saj në binarë të transformimit dhe zhvillimit modern dhe të qëndrueshëm.

110 Planin e biznesit të PTK-së, (2015-2019). http://mzhe.rks-gov.net/npmnp/repository/docs/Plani_i_Biznesit_2015_PTK_sha.pdf

111 Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2015. <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendror>

112 Kosova Press; "PTK-ja siguron vetëm 10 milionë, Qeveria-kështu shkelet ligji"; 13, Prill 2015. <http://www.kosovapress.com/sq/ekonomi/ptk-ja-siguron-vetem-10-milione-qeveria-keshtu-shkelet-ligji-39988/>

113 Intervistë me drejtorin ekzekutiv të PTK-së, Agron Mustafa, realizuar më 07.04.2015.

114 Gazeta JnK; "PDK ruan kontrollin në PTK"; Parim Olluri dhe Mimoza Kqiku; Shkurt, 2015. <http://gazetajnk.com/?cid=1,2,9647>

115 Shih reagimin e kryeministrit Isa Mustafa; <http://koha.net/?id=27&l=45464> Në kuadër të kandidatëve që kishin konkurruar për pozitën e krye-shefit të PTK-së, ishte edhe Xhelil Bekteshi, ish drejtor i Drejtorisë së Financave në Komunën e Prishtinës deri sa kryeministri Isa Mustafa ishte kryetar komune.

10. PËRFUNDIM

Vitaliteti dhe zhvillimi i qëndrueshëm i PTK-së do të ishte siguruar po që se një kornizë e rregullave dhe sidomos e praktikave të qeverisjes së mirë korporative të OECD-së të ishin zbatuar. Lidhur me këtë fakt, integriteti i kornizës së përgjithshme të qeverisjes së sektorit të telekomunikacionit në disa raste ka qenë i rrezikuar pikërisht për shkak të shkeljes së rëndë të parimeve të OECD-së.

Disa nga aspektet më të spikatura për sa i përket shkeljeve të parimeve të OECD-së, përfshijnë: 1) cenimi në disa raste i integritetit dhe pavarësisë së rregullatorit (ARKEP); 2) ndërhyrja shumë e ashpër e politikës, industrisë së telekomunikacionit por edhe akterëve ndërkombëtar në tregun e telekomunikacionit; 3) mungesa e mekanizmave efektiv të mbikëqyrjes; 4) përhapja shumë e madhe e rasteve të konfliktit të interesit; 5) niveli i lartë i politizimit dhe nepotizmit në PTK, dhe; 6) mungesa e transparencës dhe e llogaridhënies nga ana e aksionarit - qeverisë, por edhe e BD-së dhe e menaxhmentit të PTK-së.

Që nga hyrja në treg e operatorit të dytë të telefonisë mobile më 2007, PTK-ja ka shënuar tkurrije lineare të përqindjes së përdoruesve të telefonisë mobile por edhe të përqindjes së të hyrave. Ky trend negativ ka ardhur jo vetëm si pasojë e konkurrencës në treg, por para së gjithash, si rrjedhojë e ndërhyrjeve të ndryshme politike, atyre të industrisë së telekomunikacionit dhe akterëve të tjerë ndërkombëtar. Në kuadër të kësaj kornize veprimi, PTK-ja e ka pasur pothuajse të pamundur përballimin e konkurrencës shumë të ashpër të ardhur nga dy operatorët e telefonisë mobile.

Efekt shumë negativ në qëndrueshmërinë e përgjithshme të ndërmarrjes ka luajtur edhe vendimi i qeverisë për ndalje të investimeve kapitale si pasojë e fillimit të procesit të transformimit të pronës (privatizimit) të PTK-së. Ndalesa në investime kapitale ka zgjatur për më shumë se tri vite dhe efektet dërmuese për ndërmarrjen janë evidente. Të dhënat e ARKEP-it, tregojnë se që nga momenti i parë i këtij vendimi, PTK-ja ka shënuar rënie në të hyra si në ato të telefonisë mobile edhe në ato të internetit fiks, përfshirë edhe humbje të tregut të përdoruesve të këtyre dy shërbimeve.

Vërehet qartazi se arsyeja kryesore që e ka shpëtuar PTK-në, nga rënia totale e të hyrave dhe vlerës së saj ka qenë natyra konservative dhe mungesa e theksuar e fleksibilitetit të konsumatorëve të saj për të kaluar tek operatorët e tjerë mobil se sa drejtimi strategjik që i është bërë ndërmarrjes

si nga aksionari (qeveria), Bordi apo personeli menaxherial. Sidoqoftë, ndryshimet e shpejta teknologjike, e njohur si teknologjia brez-gjerë, bashkëdyzuar me përqindjen shumë të re të popullatës në vend, do t'ia pamundësojnë PTK-së ruajtjen e konsumatorëve aktual po që se ndërmarrja nuk do të vazhdojë transformimin e saj strukturor.

Në këtë kuadër, duhet theksuar se PTK-ja sot gjendet para një sfide shumë domethënëse ku rënia e vazhdueshme dhe e pashmangshme e vlerës së saj nuk do të mund të ndalet në rast se ndërmarrja do të vazhdojë fokusin e saj në ofrimin e shërbimeve të telefonisë së zërit. PTK-ja, ashtu siç edhe e parasheh në Planin e Biznesit (2015-2019), duhet të transformohet në një ndërmarrje me fokus në ofrimin e shërbimeve që mundësojnë shkëmbimin e të dhënave me shpejtësi super të shpejtë, i cili transformim do t'i mundësojë PTK-së integrimin e shërbimeve multimediale (zë, internet, video). PTK-ja duhet të vazhdojë investimet në shtrirjen e rrjetit të fibrave optik dhe ofrimin e pajisjeve moderne, posaçërisht për sa i përket përdoruesve fundor, të modernizojë dhe digjitalizojë sistemin e faturimit dhe të ndryshojë cilësisht marrëdhëniet me konsumatorët e saj.

11. REKOMANDIME

PËR AKSIONARIN - QEVERINË E KOSOVËS:

- Të ndalojë praktikat e deritashme të ndërhyrjes politike përmes vendosjes së anëtarëve partiak dhe jo profesionistë në poste vendim-marrëse dhe manaxhuese të PTK-së.
- Në rast të vlerësimit si të pashmangshme, të rishikojë Ligjin për Ndërmarrje Publike, përkritazi kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të bordeve të NP-ve, duke siguruar pavarësinë partiake dhe profesionalizmin e tyre.
- Të përkrahë vazhdimin e planit(eve) të investimeve kapitale në PTK duke mos ndërmarrë vendim(me) që rrezikojnë strategjinë e investimeve kapitale.
- Të bashkëpunojë ngushtë me Bordin dhe menaxhmentin e PTK-së, në rishikimin eventual të Planit të Biznesit 2015-2019, dhe të mbështes transformimin e ndërmarrjes nga një operator i fokusuar në shërbime të telefonisë së zërit në një ndërmarrje që ofron shërbime me shpejtësi super të shpejtë.
- Të mos fillojë procesin e transformimit të pronës së PTK-së (privatizimin), para se ndërmarrja të stabilizojë trendin në rënie të përdoruesve dhe të të hyrave posaçërisht nga telefonia mobile.
- Të rishikojë, studiojë dhe të bëjë publike planet eventuale për vendosje të PTK-së, nën menaxhim ndërkombëtar.
- Të sigurojë qasje në dokumentet bazë, të mos anashkalojë Kuvendin e Kosovës nga procesi vendim-marrës, si dhe të garantojë pjesëmarrje të publikut në procesin eventual të privatizimit të pronës së PTK-së.
- Të sigurojë pavarësinë dhe profesionalizimin e Rregullatorit - ARKEP.

PËR BORDIN DHE MENAXHMENTIN E PTK-SË:

- Të mbikëqyrë në mënyrë shumë më rigoroze punën e menaxhmentit të PTK-së dhe të kërkojë llogari periodike.
- Të rishikojë sa më parë Planin e Biznesit 2015-2019, posaçërisht për sa i përket parashikimeve të rritjes së të hyrave të ndërmarrjes.
- Të rishikojë sa më parë Planin e Biznesit 2015-2015, dhe të sigurojë që planet për strukturim të jenë në harmoni me ndryshimet dhe zhvillimet teknologjike dhe t'u përgjigjen mundësive dhe domosdoshmërive reale të ndërmarrjes për transformim strukturor.
- BD-ve të fillojë të përpilojë dhe publikojë raporte periodike mbi punën e menaxhmentit të PTK-së, posaçërisht për sa i përket zbatimit të Planit të Biznesit 2015-2019.
- Të rishikojë marrëdhënien me konsumatorin.

PËR ARKEP-IN:

- Të përmbahet nga ndërhyrjet politike por edhe ato të industrisë së telefonisë mobile duke zbatuar normat ligjore që garantojnë pavarësinë e institucionit si dhe sigurojnë treg të hapur, të paanshëm dhe konkurrues.

PËR NJPMNP:

- Të sigurojë publikimin e raporteve vjetore të rregullta të monitorimit dhe të vlerësimit të NP-ve, dhe posaçërisht të përmirësues cilësinë e përmbytjes së tyre.

PËR KOMUNITETIN NDËRKOMBËTAR:

- Të ndalojë praktikën e deritanishme të ndërhyrjes në procesin(et), e transformimit të pronës publike (privatizimin), dhe të mbështesë një proces të mirëfilltë të strukturimit dhe zhvillimit të PTK-së.

